



Udhëzuesi Praktik i EASO-s: Kualifikimi për të përfituar mbrojtjen ndërkombëtare

*Seria e Udhëzuesve Praktikë
të EASO-s*

prill 2018



Ky projekt u financua nga Bashkimi Evropian

Ky botim u përkthye falë asistencës së Bashkimit Evropian nëpërmjet projektit “Mbështetje rajonale për menaxhimin e migracionit me fokus të mbrojtja në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi - Faza II”. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e EASO-s dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

As Zyra Evropiane e Mbështetjes për Azilin, as personat që veprojnë në emër të Zyrës Evropiane të Mbështetjes për Azilin nuk janë përgjegjës për përdorimin që mund t'u bëhet informacioneve të mëposhtme.

Luksemburg: Zyra e Publikimeve e Bashkimit Evropian, 2021

© Zyra Evropiane e Mbështetjes për Azilin, 2021

Riprodhimi autorizohet me kusht që të bëhet i ditur burimi.

Për çdo përdorim ose riprodhim të fotografive ose të materialeve të tjera për të cilat Zyra Evropiane e Mbështetjes për Azilin nuk ka të drejtat e autorit duhet të merret leje drejtpërdrejt te zotëruesi i të drejtave të autorit.

Print ISBN 978-92-9485-853-5 doi:10.2847/215 BZ-04-17-885-SQ-C
PDF ISBN 978-92-9485-855-9 doi:10.2847/489911 BZ-04-17-885-SQ-N

Udhëzuesi Praktik i EASO-s: Kualifikimi për të përfituar mbrojtjen ndërkombëtare

*Seria e Udhëzuesve Praktikë
të EASO-s*

prill 2018

Ky udhëzues praktik është zhvilluar në pajtim me metodologjinë e Matricës së Cilësisë së EASO-s. EASO dëshiron të falënderojë ekspertët e Shteteve Anëtare të BE-së dhe Grupin e Referimit (përbërë nga Komisioni Evropian, Komisari i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët dhe Këshilli Evropian për Refugjatët dhe të Mërguarit) për kontributin e tyre aktiv dhe mbështetjen gjatë zhvillimit të udhëzuesit praktik.

Hyrje në Udhëzuesin Praktik të EASO-s: Kualifikimi për të përfituar mbrojtjen ndërkombëtare

Pse u krijua ky udhëzues praktik? Udhëzuesi Praktik i EASO-s: Kualifikimi për të përfituar mbrojtjen ndërkombëtare është një mjet praktik që shoqëron zyrtarët e ngarkuar me trajtimin e dosjeve brenda Bashkimit Evropian, por edhe përtej, në punën e tyre të përditshme.

Synimi i udhëzuesit praktik është të ndihmojë në shqyrtimin e çdo aplikimi për mbrojtje ndërkombëtare në mënyrë individuale, objektive e të paanshme dhe në zbatimin e kritereve të njëjta ligjore e standarde të përbashkëta në momentin e përcaktimit se kush plotëson kushtet për mbrojtje ndërkombëtare.

Pikënisja e këtij udhëzuesi janë dispozitat ligjore të Konventës së Gjenevës të vitit 1951 dhe Direktiva e Kualifikimit (Direktiva 2011/95/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 13 dhjetor 2011 “Për standardet e kualifikimit të shtetasve të vendeve të treta ose të personave pa shtetësi si përfitues të mbrojtjes ndërkombëtare, për një status të unifikuar për refugjatët ose për personat që kualifikohen për mbrojtje plotësuese dhe për përmbajtjen e mbrojtjes së dhënë”). Udhëzuesi hedh një hap më tej dhe përkthen këto kërkesa ligjore në udhëzime për profesionistët.

Cili është objekti i këtij udhëzuesi praktik? Ky udhëzues përqendrohet tek ata që plotësojnë kushtet për mbrojtje ndërkombëtare, duke iu referuar si statusit të refugjatit, ashtu edhe mbrojtjes plotësuese. Për çështje njëtrajtimërie me terminologjinë e përdorur në Direktivën e Kualifikimit preferohet termi “kualifikim”. Ky term kuptohet si i barasvlershëm me termat “pranueshmëri” dhe “përfshirje”, të përdorura në produktet e tjera të Zyrës Evropiane për Mbështetjen e Azilit (EASO).

Udhëzuesi u zhvillua në kontekstin e bisedimeve të vazhdueshme për rregulloren e propozuar të kualifikimit. Megjithatë, përmbajtja e tij bazohet dhe u referohet dispozitave të Direktivës aktuale të Kualifikimit. Gjatë gjithë kohës përdoruesi duhet ta lexojë udhëzuesin në lidhje me dispozitat përgjegjëse të instrumentit ligjor përkatës në fuqi dhe të jetë i informuar për to.


Udhëzuesi hedh vështrim mbi kërkesat ligjore të kualifikimit për mbrojtje ndërkombëtare dhe nuk merr në konsideratë çështjet e analizës dhe vlerësimit të fakteve. Për udhëzime lidhur me këto çështje, përdoruesi duhet të shohë [Udhëzuesin Praktik të EASO-s: Intervista Personale](#) dhe sidomos [Udhëzuesin Praktik të EASO-s: Vlerësimi i Provave](#).

Për më tej, çështja e përjashtimit të personave që konstatohen se nuk e meritojnë mbrojtjen ndërkombëtare është jashtë fushëveprimit të këtij udhëzuesi praktik. Për këtë çështje mund të gjeni udhëzime në [Udhëzuesin Praktik të EASO-s: Përjashtimi](#). Përjashtimi dhe mbrojtja e statusit të refugjatit parashikuar në Nenin 1, seksioni D, të Konventës së Gjenevës dhe në Nenin 12, paragrafi 1, të Direktivës së Kualifikimit nuk janë trajtuar me detaje brenda objektivit të këtij udhëzuesi.

Kush duhet ta përdorë udhëzuesin? Ky udhëzues u drejtohet kryesisht zyrtarëve të ngarkuar me trajtimin e dosjeve, intervistuesve dhe vendimmarrësve brenda autoriteteve kombëtare përgjegjëse për të përcaktuar statusin e refugjatit. Gjithashtu, mund të jetë i dobishëm për politikëbërësit, përgjegjësit e cilësisë e këshilltarët ligjorë si dhe për këdo që i intereson çështja e kualifikimit për mbrojtje ndërkombëtare në kontekstin e BE-së.

Udhëzuesi synon t’u vijë në ndihmë nevojave të zyrtarëve që trajtojnë dosjet me shkallë të ndryshme përvoja, që nga zyrtarët e rinj deri te ata me vite përvojë. Shtresat dhe përmbajtja e tij mund të përdoren në mënyra të ndryshme, në varësi të nevojave të përdoruesit.

Si ta përdorim këtë udhëzues praktik? Udhëzuesi është strukturuar në katër shtresa të cilat mund të përdoren më vete ose në mënyrë të ndërlydhur.



Përveç orientimit të strukturuar, ky udhëzues praktik mund të shihet edhe si mjet për vetëvlerësimin. Mund të përdoret edhe si mjet për kontrollin e cilësisë dhe/ose formimin.

Si u zhvillua ky udhëzues praktik? Udhëzuesi u krijua nga ekspertë të shteteve BE+, me kontributin e çmuar të Komisionit Evropian dhe të Komisarit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatët. Hartimi i tij u mbështet dhe u bashkërendua nga EASO. Para përfundimit të udhëzuesit u zhvillua një konsultim me të gjitha shtetet BE+.

Si lidhet me legjislacionin dhe praktikën vendase ky udhëzues? Ky është një mjet konvergjence që pasqyron standardet e përbashkëta dhe përmban hapësira të posaçme për ndryshimet në legjislacionin, orientimet dhe praktikën kombëtare.

Në hapësirat e përcaktuara të udhëzuesit, çdo autoritet kombëtar mund të përfshijë elemente të normave ligjore dhe orientimeve kombëtare në mënyrë që t'u japë zyrtarëve të ngarkuar me dosjet një pikë të vetme orientimi për kualifikimin për mbrojtje ndërkombëtare.

Si lidhet ky udhëzues praktik me mjetet e tjera mbështetëse të EASO-s? Misioni i EASO-s është t'u japë mbështetje Shteteve Anëtare, ndër të tjerash, nëpërmjet trajnimeve të përbashkëta, cilësisë së përbashkët dhe informacionit të përbashkët për vendin e origjinës. Ashtu si të gjitha mjetet mbështetëse të EASO-s, *Udhëzuesi Praktik i EASO-s: Kualifikimi për të përfutuar mbrojtjen ndërkombëtare* mbështetet në standardet e Sistemit të Përbashkët Evropian të Azilit. Ai ndërtohet mbi kuadrin e njëjtë dhe duhet parë si plotësues i mjeteve të tjera të disponueshme të EASO-s. Konsiderata e parë ka qenë koherenca e udhëzuesit me këto mjete, sidomos me modulet e trajnimit të EASO-s që janë ngushtësisht të lidhura si "Përfshirja" dhe "Përfshirja niveli i avancuar". *Qualification for international protection (Directive 2011/95/EU) — A judicial analysis* [Kualifikimi për mbrojtje ndërkombëtare (Direktiva 2011/95/BE) — Një analizë gjyqësore] prodhuar nga Shoqata Ndërkombëtare e Gjyqtarëve të Drejtësisë për Refugjatët [IARLJ-Europe], kontraktuar nga EASO, ishte gjithashtu një burim i vlefshëm gjatë zhvillimit të këtij mjeti.

Ky është një udhëzues praktik i zhvilluar brenda procesit të matricës së cilësisë së EASO-s dhe duhet përdorur në kombinim me mjetet e tjera praktike të disponueshme: <https://www.easo.europa.eu/practical-tools>

Përmbajtja

Hyrje në <i>Udhëzuesin Praktik të EASO-s: Kualifikimi për të përfituar mbrojtjen ndërkombëtare</i>	3
LISTË KONTROLLI	7
ORIENTIME	10
Parime të përgjithshme	11
Kuai ligjor: Konventa e Gjenevës dhe Direktiva e Kualifikimit.....	11
Rrethanat individuale.....	12
Procesi i vendimmarrjes.....	12
“Jashtë vendit të origjinës”: fushëveprimi personal dhe territorial.....	13
Shtetasit e vendeve të treta.....	13
Personat pa shtetësi	13
Rëndësia e përcaktimit të vendit të origjinës	14
Jashtë vendit të origjinës	15
Statusi i refugjatit: frika e bazuar për përndjekje	16
Përndjekja	16
1. A është akti shkelje mjaft e rëndë e të drejtave të njeriut nëse ka marrë një nga format e mëposhtme?	17
2. A përbën akti shkelje të një të drejte të pashmangshme të njeriut ose shkelje mjaft e rëndë të një të drejte tjetër themelore të njeriut?.....	19
3. A mundet që trajtimi të konsiderohet si akumulim i disa masave të ndryshme, pasojat e të cilave mund të ndikojnë te azilkërkuesi në mënyrë të ngjashme?	20
Frika e bazuar	20
Statusi i refugjatit: arsyet për përndjekje	22
Raca.....	22
Feja.....	22
Kombësia.....	23
Përkatësia në një grup të caktuar shoqëror	23
Karakteristikat e përbashkëta.....	24
Perceptimi i identitetit të dallueshëm	24
Bindjet politike	25
Lidhja (për shkak të).....	26
Mbrojtja plotësuese	27
Rreziku real	27
Dëmi serioz	27
Dënimi me vdekje ose ekzekutimi	27
Tortura ose trajtimi apo dënimi çnjerëzor ose poshtërues	28
Tortura	29
Trajtimi apo dënimi çnjerëzor ose poshtërues	29
Kërcënimi i rëndë dhe individual kundër jetës ose personit të civilit për shkak të dhunës së ushtruar pa dallim në situatat e konflikteve të armatosura ndërkombëtare ose të brendshme	30
Konflikt i armatosur ndërkombëtar ose i brendshëm	30
Civilët	31
Dhuna pa dallim.....	31
Kërcënimi serioz dhe individual	32
Jeta ose personi	33
Lidhja (për shkak të).....	33
Nevojat për mbrojtje ndërkombëtare që lindin jashtë vendit të origjinës <i>sur place</i>	34

Autorët e përndjekjes ose të dëmit serioz	35
Mbrojtja në vendin e origjinës	36
Përgjegjësit për mbrojtjen	36
Cilësia e mbrojtjes	38
E efektshme	38
Me natyrë të përhershme	38
E arritshme	38
Alternativa ndaj mbrojtjes brenda vendit.....	39
Siguria në një pjesë të vendit të origjinës.....	39
Qasja në pjesë të vendit të origjinës	40
Azilkërkuesi e gjen të arsyeshme të vendoset në një pjesë të vendit të origjinës	40
Mosdashja e azilkërkuesit për të përfitur mbrojtje në vendin e origjinës	41
DIAGRAME	42
REFERENCAT	50
Shkurtime dhe lidhje të dobishme	51
Burime të tjera	51
Referencat ligjore dhe jurisprudenca përkatëse	51
Parime të përgjithshme	51
Fushëveprimi personal dhe territorial	52
Statusi i refugjatit: frikë e bazuar nga përndjekja	52
Arsyet për përndjekje: raca	53
Arsyet për përndjekje: feja	54
Arsyet për përndjekje: kombësia	54
Arsyet për përndjekje: anëtarësia në një grup të caktuar shoqëror	54
Arsyet për përndjekje: bindjet politike	55
Lidhja (për shkak të).....	55
Mbrojtja shtesë: rreziku real për dëm serioz	55
Mbrojtja plotësuese: dënimi me vdekje ose ekzekutimi	56
Mbrojtja plotësuese: tortura ose trajtimi apo dënimi çnjerëzor ose poshtëruar	56
Mbrojtja plotësuese: kërcënimi serioz dhe individual për jetën ose personin e civilin për shkak të dhunës pa dallim në situatat e konflikteve të armatosura ndërkombëtare ose të brendshme	57
Nevojat për mbrojtje që lindin aty për aty <i>“sur place”</i>	57
Autorët e përndjekjes ose dëmit serioz.....	58
Përgjegjësit për mbrojtjen dhe cilësia e mbrojtjes	58
Alternativa e mbrojtjes së brendshme	59

LISTË KONTROLLI

- ▶ *Kujtesë praktike për ata që e njohin temën e kualifikimit për mbrojtje ndërkombëtare.*
- ▶ *Përdorni hiperlidhjet për udhëzime plotësuese lidhur me një temë të caktuar.*

Parime të përgjithshme

- Zbatoni dispozitat ligjore për faktet e pranuar materiale dhe rezultatet e vlerësimit të rrezikut.
- Mbani mend se kualifikimi për të përfituar statusin e refugjatit duhet të jetë gjithmonë gjëja e parë që duhet shqyrtuar.
- Mbani mend se nevoja për mbrojtje mund të lindë *sur place* (aty për aty).
- Shqyrtoni çdo çështje më vete, në mënyrë objektive dhe të paanshme.

“Jashtë vendit të origjinës”: fushëveprimi personal dhe territorial

- Përcaktoni kombësinë e azilkërkuesit ose vendin ku ai ka pasur vendin e banimit të përhershëm.

Statusi i refugjatit: frikë e bazuar nga përndjekja

Përndjekja

Vlerësoni nëse një trajtim i caktuar mund të konsiderohet përndjekje duke marrë parasysh pyetjet e mëposhtme.

- A përbën akti shkelje të rëndë të të drejtave të njeriut duke marrë një prej formave të përmendura, ndër të tjera, në Nenin 9, paragrafi 2, të Direktivës së Kualifikimit?
- A përbën akti shkelje të një të drejte të pashmangshme të njeriut ose një shkelje mjaft të rëndë të një të drejte tjetër themelore të njeriut?
- A mundet që trajtimi të konsiderohet si akumulim i disa masave të ndryshme, pasojat e të cilave mund të ndikojnë te azilkërkuesi në mënyrë të ngjashme?

Frika e bazuar

- Vlerësoni nëse frika e azilkërkuesit është e bazuar.
 - Konsideroni të gjitha faktet materiale që janë pranuar dhe vërtetoni nëse vërtet në të shkuarën ka pësuar ose është kërcënuar me përndjekje.
 - Nëse praktika vendase e lejton, konsideroni nëse përndjekja e pësuar në të shkuarën ka qenë me karakter aq mizor, sa dëmi do të konsiderohej i vazhdueshëm edhe nëse përndjekja nuk do të përsëritej.
 - Analizoni nëse është arritur pragu i “frikës së bazuar” (shkallë e arsyeshme probabiliteti).

Statusi i refugjatit: arsyt për përndjekje

Shqyrtoni nëse përndjekja së cilës i trembet azilkërkuesi lidhet me një prej arsyeve të mëposhtme (reale ose të hamendësuar).

<input type="checkbox"/> Raca	<ul style="list-style-type: none"> ▪ ngjyra ▪ prejardhja ▪ përkatësia në një grup të veçantë etnik
<input type="checkbox"/> Feja	<ul style="list-style-type: none"> ▪ të pasurit besim teist, joteist apo ateist, ▪ pjesëmarrja ose mospjesëmarrja në ceremonitë e kultit, të kremtuara në mënyrë private ose publike, qoftë vetëm apo bashkë me të tjerë, ▪ pjesëmarrja ose mospjesëmarrja në aktet e tjera fetare ose të shprehjes së besimit ▪ pjesëmarrja ose mospjesëmarrja në forma sjelljeje personale ose shoqërore të bazuar në besimin fetar ose në kërkesat e tij
<input type="checkbox"/> Kombësia	<ul style="list-style-type: none"> ▪ nënshtetësia ose mungesa e saj ▪ identiteti kulturor ▪ identiteti etnik ▪ identiteti gjuhësor ▪ origjinat e përbashkëta gjeografike ose politike ▪ marrëdhënia me popullatën e një shteti tjetër

Statusi i refugjatit: arsytet për përndjekje

<input type="checkbox"/> Përkatësia në një grup të veçantë shoqëror	<ul style="list-style-type: none"> të kesh ose të perceptosh se ke një karakteristikë të përbashkët dhe të kesh ose të perceptosh se ke identitet të dallueshëm
<input type="checkbox"/> Bindjet politike	<ul style="list-style-type: none"> të pasurit e opinioneve, mendimeve ose besimit për çështje të lidhura me autorët potencialë të përndjekjes, me politikat ose metodat e tyre pavarësisht faktit nëse azilkërkuesi i ka kthyer në veprime këto opinione, mendime ose besim
<input type="checkbox"/> Vërtetoni se ekziston një lidhje midis karakteristikës (reale ose të hamendësuar) dhe përndjekjes së cilës i trembet azilkërkuesi.	

Mbrojtja plotësuese

Rreziku real

- Konsideroni të gjitha faktet materiale që janë pranuar dhe vërtetoni nëse vërtet se në të shkuarën ka pësuar ose është kërcënuar me dëme serioze.
- Nëse praktika vendase e lejon, konsideroni nëse dëmi serioz në të shkuarën ka qenë me karakter aq mizor, sa dëmi do të konsiderohej i vazhdueshëm, edhe nëse nuk do të vazhdonte.
- Analizoni nëse është arritur pragu i “rrezikut real” (shkallë e arsyeshme probabiliteti).

Dëmi serioz

Vlerësoni nëse ka rrezik real për:

- dënim me vdekje ose ekzekutim;
- torturë, trajtim ose dënim çnjerëzor ose poshtërues të një azilkërkuesi në vendin e origjinës;
- kërcënim serioz dhe individual të jetës ose personit të një civil për shkak të dhunës pa dallim në situata konflikti të armatosur ndërkombëtar ose brenda vendit.

Autorët e përndjekjes ose dëmit serioz

- Përcaktoni autorët e përndjekjes ose dëmit serioz.

Mbrojtja në vendin e origjinës

Përgjegjësit për mbrojtjen

- Mendoni cilët mund të jenë përgjegjësit potencialë për mbrojtjen:
 - Shteti;
 - partitë dhe organizatat, përfshirë organizatat ndërkombëtare, që kontrollojnë shtetin ose një pjesë të konsiderueshme të territorit të shtetit.

Vërtetoni nëse ky përgjegjës është:

- i aftë** të japë mbrojtje:
 - efektive;
 - të përhershme;
 - të arritshme;
- i gatshëm** t’ia japë këtë mbrojtje azilkërkuesit.

Alternativa e mbrojtjes së brendshme

- Shqyrtoni nëse ekziston ndonjë pjesë specifike e vendit të origjinës ku azilkërkuesi nuk e ka frikën e bazuar se mund të përndiqet dhe nuk është në rrezik real nga vuajtja e dëmeve serioze ose ku i jepet mbrojtje nga përndjekja dhe dëmi serioz.
 - Analizoni** nëse kjo pjesë e vendit është:
 - e sigurt;
 - e arritshme;
 - vend ku është e arsyeshme të vendoset azilkërkuesi.

ORIENTIME

- ▶ *Orientim i shkurtër dhe pamor nëpërmjet elementeve të ndryshme gjatë shqyrtimit të aplikimit për mbrojtje ndërkombëtare.*
- ▶ *Përdorni hapësirat e zbrazëta për të shtuar referencat në legjislacion, orientimet dhe praktikën vendase.*

Parime të përgjithshme [\[kthehu te listë kontrolli\]](#)

Kuadri ligjor: Konventa e Gjenevës dhe Direktiva e Kualifikimit

Duhet nënvizuar se mbrojtja ndërkombëtare merret në konsideratë vetëm kur nuk ekziston mbrojtja në vendin e origjinës, pra është një zëvendësuese e mbrojtjes në vendin e origjinës.

Konventa e Gjenevës e vitit 1951 për statusin e refugjatit dhe Protokollin i saj i vitit 1967 janë instrumentet kryesore ligjore ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes ndërkombëtare, sidomos sa i takon statusit të refugjatit dhe parimit të moskthimit (non-refoulement). Si rrjedhojë, nëpërmjet miratimit të Direktivës së Kualifikimit (DK) në BE hyri një formë e re mbrojtjeje, mbrojtja plotësuese. DK-ja përcakton kriteret ligjore që duhen përmbushur për të përfitur mbrojtjen plotësuese dhe zhvillon më tej kriteret për statusin e refugjatit. Sa i takon statusit të refugjatit, zbatimi i dispozitave të DK-së duhet të mbështetet në zbatimin e plotë dhe gjithëpërfshirës të Konventës së Gjenevës.

Statusi i Refugjatit dhe mbrojtja plotësuese në pajtim me DK-në.

"Refugjat" nënkupton:

shtetasin e vendit të tretë ose personin pa shtetësi, i cili si pasojë e frikës së bazuar për përndjekje për shkak të racës, besimit, kombësisë, anëtarësisë në një grup të caktuar shoqëror ose bindjes politike ndodhet jashtë vendit të shtetësisë së tij ose të vendbanimit të zakonshëm të mëparshëm dhe nuk është në gjendje ose, i detyruar nga kjo frikë, nuk ka dëshirë të kërkojë mbrojtjen e atij vendi ose i ndodhur jashtë vendit të vendbanimit të zakonshëm nuk është në gjendje ose nuk ka dëshirë të kthehet në atë vend dhe për të cilin nuk zbatohet Neni 12 [përfshirë].


- Neni 2 (d), i DK-së

"Person i pranueshëm për mbrojtje plotësuese" nënkupton:

një shtetas të një vendi të tretë ose një person pa shtetësi që nuk kualifikohet si refugjat, por për të cilin ekzistojnë arsye serioze për të besuar se personi në fjalë, nëse kthehet në vendin e tij të origjinës ose në rastin e një personi pa shtetësi, në vendin e tij të mëparshëm të banimit, do të përballej me një rrezik real që të pësojë dëm serioz sipas përkufizimeve të Nenit 15 [dënim me vdekje ose ekzekutim; torturë, trajtim ose dënim çnjerëzor ose poshtëruar; kërcënim serioz dhe individual për jetën e civilit ose personit për shkak të dhunës së verbër në situata konflikti ndërkombëtar ose brenda vendit] dhe për të cilin nuk zbatohet Neni 17 paragrafi 1 dhe 2 [përfshirë] dhe i cili nuk është në gjendje, ose si pasojë e këtij rreziku, nuk ka dëshirë të përfitojë mbrojtjen e atij vendi.

- Neni 2 (f), i DK-së

Kualifikimi për statusin e refugjatit gjithmonë duhet të jetë gjëja e parë që duhet shqyrtuar. [\[kthehu te listë kontrolli\]](#)



Rrethanat individuale [\[kthehu te listë kontrolli\]](#)

Direktiva e Kualifikimit
Neni 4

Shqyrtimi i aplikimeve dhe marrja e vendimeve për mbrojtje ndërkombëtare duhet të jenë gjithmonë individuale, objektive dhe të paanshme.


Analiza që bëhet rast pas rasti duhet të marrë parasysh këto elemente kyçe:

- të gjithë elementet e rëndësishme sepse ato lidhen me vendin e origjinës në momentin e marrjes së vendimit për aplikimin;
- veprimet dhe kërcënimet ndaj të cilave azilkërkuesi ka qenë i ekspozuar ose mund të jetë i ekspozuar;
- situata individuale e azilkërkuesit, përfshirë faktorët si e shkuara, gjinia dhe mosha;
- nëse mbrojtja në vendin e origjinës është e disponueshme dhe e arritshme.

Nevojat për mbrojtje në fillim vlerësohen lidhur me zonën ku azilkërkuesi ka vendbanimin në vendin e origjinës. Zona e vendbanimit në vendin e origjinës identifikohet nisur nga fortësia e lidhjeve të azilkërkuesit me një zonë të caktuar në atë vend. Zona e vendbanimit mund të jetë vendi ku azilkërkuesi është lindur ose rritur ose një zonë tjetër ku azilkërkuesi ka banuar dhe jetuar, prandaj ka lidhje të forta me të.

Procesi i vendimmarrjes [\[kthehu te listë kontrolli\]](#)

Procesi i vendimmarrjes mund të shihet si një proces me dy etapa: vlerësimi i provave (vërtetimi i fakteve) dhe vlerësimi ligjor (zbatimi i ligjit). Pasi vërtetohen rrethanat e fakteve (shih *Udhëzuesin Praktik të EASO-s: Vlerësimi i provave*), zyrtari i ngarkuar me dosjen duhet të vlerësojë nëse përmbushen kushtet themelore të parashikuara nga DK-ja për dhënien e mbrojtjes ndërkombëtare. Ky udhëzues praktik përqendrohet në etapën e dytë.



Etapat e vendimmarrjes në pajtim me vendimin e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian (GjDBE) *M.M.* (çështja C-277/11).

Etapa 1 duhet të përfundojë me të kuptuarit qartë se cilat fakte materiale janë pranuar (vlerësimi i besueshmërisë) dhe bazuar në ato fakte, shkalla e probabilitetit që azilkërkuesi t'u nënshtrohet trajtimeve që mund të konsiderohen përndjekje ose dëme serioze (vlerësimi i rrezikut).

Në **etapën 2**, zyrtari i ngarkuar me dosjen duhet të marrë faktet materiale të pranuar bashkë me rezultatet e vlerësimit të rrezikut dhe të zbatojë dispozitat ligjore përkatëse, siç shpjegohet në këtë udhëzues.

“Jashtë vendit të origjinës”: fushëveprimi personal dhe territorial [kthehu te listë kontrolli]

Fushëveprimi personal

- Sipas përkufizimit të termave “refugjat” dhe “person që ka të drejtë të përfitojë mbrojtje shtesë”, fushëveprimi personal i DK-së kufizohet te **shtetasit e vendeve të treta ose personat pa shtetësi**.

Fushëveprimi territorial

- Vendi i origjinës” nënkupton vendin ose vendet kombësinë e të cilëve mban azilkërkuesi ose, për personat pa shtetësi, vendin ku ka pasur banesën e zakonshme. Personi duhet të jetë **jashtë vendit të origjinës**.

Shtetasit e vendeve të treta

Referenca “shtetas i vendit të tretë” do të thotë se shtetasit e Shteteve Anëtare të BE-së nuk janë subjekt i fushëveprimit personal të DK-së.

Duhet të jetë e qartë se kushdo ka të drejtë të aplikojë për mbrojtje ndërkombëtare. Megjithatë, në pajtim me Protokollin Nr. 24 “Për azilin e shtetasve të Shteteve Anëtare të BE-së”, pjesë e versionit të konsoliduar të Traktatit për Funkionimin e Bashkimit Evropian, “Nisur nga niveli i mbrojtjes së të drejtave themelore dhe lirive nga Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian, Shtetet Anëtare duhet të konsiderohen si vende origjinë të sigurta kundrejt njëri-tjetrit për të gjitha qëllimet ligjore dhe praktike të lidhura me çështjet e azilit.”



Konsiderata specifike

Shqyrtimi i aplikimeve të shtetasve të Shteteve Anëtare të BE-së. Edhe pse kjo mund të haset rrallë në praktikë, protokollin parashikon se aplikimet nga shtetasit e Shteteve Anëtare të BE-së mund të merren në konsideratë ose të deklarohen të pranueshëm për t’u shqyrtuar nga një Shtet tjetër Anëtar, në disa rrethana specifike. Shih tekstin e plotë [këtu](#).

Personat pa shtetësi të cilët vendbanimin e zakonshëm e kanë pasur në një tjetër Shtet Anëtar të BE-së. Duhet theksuar se personat pa shtetësi me banim të dikurshëm në një Shtet Anëtar të BE-së nuk janë posaçërisht të përfshirë brenda fushëveprimit të Protokollit Nr. 24.

Personat pa shtetësi

Konventa për statusin e personave pa shtetësi përcakton se “person pa shtetësi” është “një person të cilin asnjë shtet nuk e konsideron shtetas të vetin në zbatimin e ligjeve të tij”. Parimet që qeverisin përcaktimin e gjendjes pa shtetësi duhet të nxirren nga e drejta ndërkombëtare.

Mbrojta që u jepet personave pa shtetësi në pajtim me DK-në është e njëjta me mbrojtjen që u jepet shtetasve nga vendet e treta.



Konsiderata specifike

Mund të jenë me vlerë për t’u marrë parasysh **Neni 1D i Konventës së Gjenevës dhe Neni 12, paragrafi 1, i DK-së**, që lidhen me mbrojtjen ndihmën e dhënë nga organet ose agjencitë e tjera të Kombeve të Bashkuara, përveç Komisarit të Lartë për Refugjatët (UNHCR).

Nëse kjo mbrojtje ose ndihmë ka mbaruar për çfarëdolloj arsye, pa përcaktuar në mënyrë përfundimtare pozitën e këtyre personave në pajtim me rezolutat përkatëse të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, këta persona kanë të drejtë *ipso facto* të përfitojnë nga DK-ja.

Në kuadrot ligjore të disa shteteve, individët mund të përfitojnë mbrojtje bazuar thjesht në faktin se janë pa shtetësi.

Legjislacioni dhe praktikat kombëtare

Rëndësia e përcaktimit të vendit të origjinës [\[kthehu te listë kontrolli\]](#)

Përcaktimi i vendit kombësinë e të cilit mban azilkërkuesi ose i vendit ku ai ka banuar zakonisht është me rëndësi vendimtare.

Ndërsa në shumë çështje vendi i origjinës së azilkërkuesit nuk vihet në dyshim, ka çështje kur kjo gjë është në thelb të shqyrtimit. Në këtë drejtim, zyrtarët që trajtojnë dosjen mund të marrin parasysh elementet e mëposhtme.

- Çdo shtet përcakton cilët janë shtetasit e tij sipas ligjit të brendshëm.
- Gjithsesi, përcaktimi i shtetësisë nuk është thjesht çështje referimi te legjislacioni për shtetësinë në vendin përkatës të origjinës.
- Duhet lexuar informacioni për vendin e origjinës rreth legjislacionit dhe praktikës.

Vendi i shtetësisë

- Pasi të jetë përcaktuar se kërkuesi i mbrojtjes ndërkombëtare është pa shtetësi, duhet përcaktuar vendi i vendbanimit të zakonshëm të mëparshëm.
- "Vendbanimi i zakonshëm" nënkupton se personi ka banuar, në mënyrë të ligjshme ose të paligjshme, në atë vend.
- Vlerësimi duhet të marrë parasysh kohëzgjatjen e qëndrimit në atë vend, sa i freskët ka qenë ka qëndrim dhe lidhjen e personit me vendin.
- Një person pa shtetësi mund të ketë më shumë se një vend vendbanimi të mëparshëm të zakonshëm.

Vendi i vendbanimit të zakonshëm



Konsiderata specifike

Kombësia e dyfishtë ose e shumëfishtë. Në rast kombësie të dyfishtë ose të shumëfishtë, duhet të vlerësohet nëse azilkërkuesi mund të mbrohet nga ndonjëri prej vendeve kombësinë e të cilit mban. Në rast se mbrojtja për azilkërkuesin është e disponueshme në ndonjërin prej vendeve të kombësisë të tij, ai nuk konsiderohet se ka nevojë për mbrojtje ndërkombëtare.

Shtetasit me banim në një shtet tjetër. Një tjetër mundësi është që azilkërkuesi të ketë kombësinë e një vendi të caktuar, por është me banim në një vend tjetër për një periudhë të gjatë kohe. Në këto raste, zyrtari i ngarkuar me dosjen duhet të vlerësojë nëse azilkërkuesi cilësohet si refugjat ose ka nevojë për mbrojtje plotësuese sa i përket vendit të kombësisë të tij.

Sidoqoftë, fakti që azilkërkuesi ka banuar dikur tjetër mund të jetë me rëndësi nëse konsiderohet zbatueshmëria e konceptit të një vendi të tretë të sigurt.

Heqja dorë nga kombësia. Në rast se azilkërkuesi deklaron se ka hequr dorë nga kombësia, zyrtari i ngarkuar me trajtimin e dosjes duhet të vlerësojë cilat rregulla zbatohen për heqjen dorë nga kombësia në vendin në fjalë dhe nëse veprimet e azilkërkuesit mund të kenë shkaktuar humbjen efektive të kombësisë. Nëse është ky rasti dhe nëse azilkërkuesi nuk ka shtetësi tjetër, duhet konsideruar person pa kombësi.

Jashtë vendit të origjinës

“Jashtë vendit të origjinës” është kriter i pastër i mospranisë fizike.

Direktiva 2013/32/BE për procedurat e përbashkëta për dhënien dhe heqjen e mbrojtjes ndërkombëtare (Direktiva për procedurat e azilit — DPA) specifikon më tej se dispozitat e saj zbatohen për aplikimet për mbrojtje ndërkombëtare të bëra brenda territorit, përfshirë këtu ato që bëra në kufi, në ujërat territoriale ose në zonat tranzit të Shteteve Anëtare.

Për pasojë, personin i cili aplikon për mbrojtje në një ambasadë të huaj, ndërsa gjendet ende në vendin e tij të origjinës, nuk e kap fushëveprimi territorial i DK-së dhe DPA-së.

Statusi i refugjatit: frika e bazuar për përndjekje [\[kthehu te listë kontrolli\]](#)

Përndjekja

Konventa e Gjenevës	Direktiva e Kualifikimit	Legjislacioni i brendshëm
Neni 1, seksioni A, paragrafi 2	Neni 9 Neni 4, paragrafi 4	

“Përndjekja” nuk përkufizohet në Konventën e Gjenevës. Nocioni është elastik, i përshtatshëm dhe mjaftueshëm i hapur për të pasqyruar ndryshimet e mundshme në format e përndjekjes.

Që të mund të konsiderohet përndjekje brenda kuptimit të DK-së, veprimi duhet të jetë:

a. **Mjaft serioz** për nga natyra ose shpeshtësia sa të përbëjë **shkelje të rëndë të të drejtave themelore të njeriut**, sidomos të të drejtave të pashmangshme sipas Nenit 15, paragrafi 2, të KEDNj


ose

b **Një akumulim masash të ndryshme**, ndër të cilat shkeljet e të drejtave të njeriut, ndikimi i të cilave është aq i rëndë sa të ndikojë te një individ **në mënyrë të ngjashme** me përshkrimin e dhënë në germën “a”.

Prandaj, jo çdo formë keqtrajtimi përbën përndjekje. Elementet që duhet të merren parasysh për të vlerësuar nëse është arritur në nivelin e përndjekjes janë:



Zyrtarët e ngarkuar me trajtimin e dosjeve, për të vlerësuar nëse ndonjë formë e veçantë trajtimi arrin në përndjekje mund të ndjekin një trajtim praktik me tri etapa si më poshtë.



Këto etapa janë zhvilluar më gjerë këtu më poshtë. Ato kanë për qëllim t’u japin ndihmë teknike zyrtarëve të ngarkuar me dosjet. Për të përcaktuar nëse trajtimi përbën përndjekje, duhet të arrihet gjithmonë pragu i ashpërsisë në pajtim me Nenin 9, paragrafi 1, të DK-së.

1. A është akti shkelje mjaft e rëndë e të drejtave të njeriut nëse ka marrë një nga format e mëposhtme? [\[kthehu te listë kontrolli\]](#)

Neni 9, paragrafi 2, i DK-së përmend në mënyrë specifike disa forma të cilat, ndër të tjera, cilësohen si përndjekje kur arrihet pragu i parashikuar në Nenin 9, paragrafi 1, germa “a” ose “b”, të DK-së.

- a. **Dhuna fizike ose mendore, përfshirë dhunën seksuale:** aktet e dhunës fizike ose mendore cilësohen si përndjekje nëse janë aq të shpeshta sa të cenojnë në thelb integritetin fizik të një individi ose aftësinë e tij mendore për vendimmarrje të pavarur.
- b. **Masat ligjore, administrative, policore dhe/ose gjyqësore që në vetvete janë diskriminuese ose që zbatohen në mënyrë diskriminuese;**
- c. **Ndjekja penale ose dënimi i shpërpjesëtuar ose diskriminues.**



Konsiderata specifike

A cilësohet ndjekja penale si përndjekje?

Duke qenë se mbrojtja ndërkombëtare nuk ka synim t’u bëjë të mundur personave që t’i fshihen drejtësisë në vendin e tyre të origjinës, ndjekja penale ose dënimi për një vepër penale normalisht nuk sjell si pasojë kualifikimin e këtij personi si refugjat.

Megjithatë, ndjekja penale mund të cilësohet si përndjekje dhe të shkaktojë cilësimin e personit si refugjat, nëse përmbushet njëri prej kushteve të mëposhtme dhe pasojat arrijnë pragu e ashpërsisë.

- Është kryer në shkelje të së drejtës për një proces të drejtë ligjor.
- Është diskriminuese. Një shembull i qartë mund të jetë ndjekja penale për shkak të racës, fesë, kombësisë, anëtarësisë në një grup të caktuar shoqëror ose bindjeve politike.

- Dënimi zbatohet në mënyrë diskriminuese.
- Dënimi është i shpërpjesëtuar.
- Dënimi përbën përndjekje.

Duhet nënvizuar edhe se, përveç frikës nga ndjekja penale, azilkërkuesi mund të ketë arsye të tjera për frikë të bazuar nga përndjekja. Në këto raste vëmendje e veçantë duhet t'u jepet konsideratave të mundshme të përjashtimit.

ç. Mohimi i zgjidhjes në rrugë gjyqësore që ka për rezultat një dënim të shpërpjesëtuar ose diskriminues.


d. Ndjekja penale ose dënimi për shkak të mospranimit për të kryer shërbimin ushtarak në një konflikt, ku kryerja e shërbimit ushtarak do të përfshinte kryerjen e krimeve ose veprave që janë subjekt i arsyeve për përjashtim.



Konsiderata specifike

A mund të cilësohet përndjekje dënimi për mospranimin e kryerjes së shërbimit ushtarak?

Ka dy situata në të cilat dënimi për mospranim të kryerjes së shërbimit ushtarak mund të arrijë në përndjekje.



Skenari i parë është përfshirë në mënyrë specifike ndër format e mundshme të përndjekjes nga Nenin 9, paragrafi 2, i DK-së.

Bëhet fjalë për situata në të cilat azilkërkuesi do të merrte pjesë vetëm në mënyrë të tërthortë në krime lufte, si p.sh. duke dhënë ndihmë me efekte të rëndësishme në përgatitjen ose ekzekutimin e këtyre krimeve. Përveç kësaj, ky skenar nuk vlen vetëm për situatat në të cilat është vërtetuar se krimet e luftës janë kryer tashmë, por edhe për situatat kur ka shkallë të mjaftueshme probabiliteti për një rrezik real përfshirjeje në kryerjen e këtyre krimeve.

Vlerësimi duhet të marrë parasysh edhe faktin nëse azilkërkuesi ka pasur ndonjë alternativë tjetër, përveç refuzimit të kryerjes së shërbimit ushtarak për të shmangur pjesëmarrjen në krimet e pretenduara të luftës.

Orientime shtesë për dezertimin nga ushtria jepen në seksionin “Statusi i refugjatit: arsyet për përndjekje” (nëseksioni “Bindjet politike”) më poshtë.

e. Aktet specifike të drejtuara kundër një gjinie ose kundër fëmijëve.

Aktet specifike kundër një gjinie mund të jenë p.sh. dhuna seksuale, gjymtimi i organeve gjenitale, aborti i detyruar ose sterilizimi i detyruar. Akte të tilla mund të kryhen për arsye të ndryshme, përfshirë ato të lidhura me racën, fenë, kombësinë ose bindjet politike. Këto akte mund të jenë të lidhura me gjininë ose me përkatësinë në një grup të caktuar social (shih konsideratat specifike në seksionin “Statusi i refugjatit: arsyet për përndjekje” (nëseksioni “Anëtarësia në një grup të caktuar shoqëror”) më poshtë.

Aktet specifike kundër fëmijëve mund të përfshijnë, për shembull, rekrutimin e të miturve në forcat e armatosura, trafikimin ose prostitucionin të miturve. Këtu mund të përfshihet shkelja e të drejtave specifike të të miturve, për shembull e të drejtave të parashikuara në [Konventën për të drejtat e fëmijës](#) dhe protokollet e saj fakultative.

Në rast se akti nuk hyn në asnjërin prej rasteve të mësipërme, zyrtari i ngarkuar me trajtimin e dosjes duhet gjithsesi të kalojë në konsideratat e etapës 2.

2. A përbën akti shkelje të një të drejte të pashmangshme të njeriut ose shkelje mjaft e rëndë të një të drejte tjetër themelore të njeriut? [\[kthehu te listë kontrolli\]](#)

a. Cilat të drejta?

“**Të drejtat e pashmangshme të njeriut**” janë të drejtat absolute nga të cilat nuk bëhet asnjë përjashtim, as në kohë lufte ose emergjence. Neni 15, paragrafi 2, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) parashikon një listë të drejtash që nuk mund të pezullohen në asnjë rrethanë.

E drejta për jetën (me përjashtim të rastit të vdekjes që vjen si pasojë e akteve të ligjshme të luftës)

Ndalimi i torturës dhe trajtimit ose dënimit çnjerëzor ose poshtëruës

Ndalimi i skllavërisë dhe i punës së detyruar

Parimi i ligjshmërisë në të drejtën penale (nuk është kryer krim ose dhe nuk mund të ketë dënim nëse, në momentin kur është kryer, nuk përbënte vepër penale sipas të drejtës së brendshme)

Nga instrumentet e lidhura me të drejtat e njeriut mund të rrjedhin të tjera “të drejta themelore” si për shembull.

- Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut.
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (ICCPR): Duhet nënvizuar se edhe ky pakt përmend disa të drejta si të pashmangshme. Përveç të drejtave të parashikuara në Nenin 15, paragrafi 2, të KEDNJ-së, këtu përfshihet:
 - ndalimi i burgosjes për shkak të pamundësisë për përmbushjen e detyrimeve kontraktore;
 - njohja kudo e personalitetit juridik të individit;
 - liria e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë: liria për të manifestuar besimin fetar ose bindjet mund të jetë subjekt vetëm i atyre kufizimeve që parashikohen në ligj dhe janë të nevojshme për të mbrojtur sigurinë publike, rendin, shëndetin ose moralin, ose të drejtat dhe liritë themelore të të tjerëve.
- Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor.
- Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave.
- Konventa për të Drejtat e Fëmijëve.
- Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.

Vendimi nëse të drejtat e renditura në këto instrumente mund të konsiderohen si “themelore” do të varet nga analiza nëse ato janë të drejta me rëndësi themelore dhe janë të pandashme nga individi.

b. Sa e rëndë është shkelja?

Për të vlerësuar nëse shkelja e të drejtave themelore është mjaftueshëm e rëndë, zyrtari i ngarkuar me dosjen duhet të kërkojë nëse keqtrajtimi komprometon të drejtën për ta gëzuar atë të drejtë dhe në ç’masë e komprometon.

Në rast se rasti nuk përmban elementet e mësipërme, zyrtari i ngarkuar me dosjen duhet të shkojë në etapën 3.

3. A mundet që trajtimi të konsiderohet si akumulim i disa masave të ndryshme, pasojat e të cilave mund të ndikojnë te azilkërkuesi në mënyrë të ngjashme? [\[kthehu te listë kontrolli\]](#)

Trajtimi mund të konsiderohet përndjekje edhe nëse përbën akumulim të masave të ndryshme të cilat, të marra së bashku dhe në disa raste të kombinuara me rrethana të tjera personale të pafavorshme dhe/ose duke marrë parasysh kontekstin e përgjithshëm, ndikojnë te individ i në mënyrë të ngjashme me shkeljen e të drejtave të tij themelore.

Mënyrë “e ngjashme” nuk nënkupton “në të njëjtën” mënyrë. Mund të mjaftojë një prag më i ulët ashpërsie për ta konsideruar të rëndë shkeljen. Vlerësimi duhet bërë rast pas rasti dhe duke marrë parasysh rrethanat individuale të azilkërkuesit.

Këto masa të ndryshme, për shembull, mund të shkelin të drejtat ekonomike, shoqërore dhe kulturore të azilkërkuesit si të drejtën për arsim, shëndetësi, punësim, sigurime shoqërore ose për pjesëmarrje në jetën kulturore.

Frika e bazuar [\[kthehu te listë kontrolli\]](#)

Brenda kuadrit të azilit, nocioni i “frikës së bazuar” mund të interpretohet se përmbledh dy aspekte të cilave shpesh u referohemi si elemente “subjektive” dhe “objektive”. Fokusi i vlerësimit është nëse frika është “e bazuar” ose jo (d.m.th. elementi objektiv).

“Frika”

Frika mund të përkufizohet si emocion i ankthshëm i shkaktuar nga një dëm i pritshëm, edhe nëse kërcënimi është real apo i imagjinuar.

Prandaj, aspekti subjektiv lidhet me frikën që ndjen azilkërkuesi.

Duhet nënvizuar se reagimet psikologjike ndryshojnë nga njëri individ në tjetrin, edhe kur ata përballen me të njëjtën situatë. Përjetimi i frikës është i pandashëm nga faktorë si personaliteti, moshë, sfondi socio-kulturor dhe përvojat e mëparshme të azilkërkuesit. Zyrtarët e ngarkuar me dosjen duhet të marrin në konsideratë situatën personale të azilkërkuesit si dhe shprehjen e frikës që del në sipërfaqe nga deklaratimet e tij.

Meqenëse frika e kthimit në vendin e origjinës mund të burojë nga shkaqe të shumta, nuk është e thënë që të gjitha këto shkaqe të jenë të lidhura me përndjekjen brenda kuptimit të DK-së. Përveç kësaj, nuk është e nevojshme të vërtetohet se frika nga përndjekja është motivi mbizotërues për azilkërkuesin, për sa kohë një frikë e tillë është e identifikueshme.



Konsiderata specifike

Kur azilkërkuesi nuk shpreh frikë. Në disa raste azilkërkuesi mund të mos e shprehë hapur se ndien frikë. Në raste të tjera, mund edhe të thotë se nuk ka frikë fare. Megjithatë, mungesa e frikës mund të konsiderohet e parëndësishme kur rrethanat do ta justifikonin me objektivitet faktin se kushdo në ato situata do të përballlej me një rrezik.


“E bazuar”

Frika subjektive e azilkërkuesit duhet të vërtetohet me objektivitet që të mund të konsiderohet “e bazuar”.

Duke qenë se elementi “i bazuar” në përkufizimin e refugjatit ka të bëjë me gjasat që azilkërkuesi të përballlet me përndjekjen, kjo është kryesisht çështje vlerësimi faktik të rrezikut (shih [Udhëzuesin Praktik të EASO-s: Vlerësimi i Provave](#)). Në këtë vlerësim, zyrtari i ngarkuar me dosjen duhet të konsiderojë situatën individuale të azilkërkuesit nën dritën e informacionit për situatën e përgjithshme në vendin e origjinës (p.sh. situata politike, fetare, shoqërore ose e sigurisë). Informacioni për përndjekjen e pjesëtarëve të familjes ose të personave në situatë të ngjashme me atë të azilkërkuesit mund të jetë me dobi për vlerësimin në fjalë.

Për të vlerësuar termin “e bazuar” si kriter ligjor, duhen marrë në konsideratë elementet e mëposhtme:

- ✓ Së pari, duhet nënvizuar se vlerësimi duhet të përqendrohet nëse kjo frikë është “e bazuar” **në momentin kur azilkërkuesi ka marrë vendimin për të aplikuar për mbrojtje ndërkombëtare**, pra frika e bazuar e azilkërkuesit duhet të jetë aktuale. Rrethanat që shtyjnë një person të arratiset mund të ndryshojnë ose të pushojnë së ekzistuari me kohë, ose në të kundërt mund të shfaqen pas arratisjes së tij (shih seksionin më poshtë “Lindja e nevojës për mbrojtje ndërkombëtare jashtë vendit të origjinës (*sur place*)”).
- ✓ Së dyti, “frika e bazuar” mbështetet te vlerësimi i rrezikut, i cili është **me natyrë parashikuese**. Për shkak të vështirësive të pashmangshme në të bërët e parashikimeve se çfarë do të ndodhte nëse azilkërkuesi do të kthehej mbrapsht, kemi një rrezik të lartë për vlerësim subjektiv. Prandaj, është shumë e rëndësishme që vlerësimi i frikës së bazuar të mbështetet në një metodologji objektive dhe të shmangen spekulimet. Metodologjia e lidhur me aspektin faktik të këtij vlerësimi mund të gjendet në *Udhëzuesin Praktik të EASO-s: Vlerësimi i provave*.



Konsiderata specifike

Përndjekja e pësuar në të shkuarën. Fakti që azilkërkuesi ka qenë subjekt i përndjekjes në të shkuarën, në vetvete nuk nënkupton se ekziston rreziku i persekutimit në të ardhmen. Megjithatë, përndjekja ose kërcënimet e shkuara mund të jenë tregues seriozë për frikë të bazuar. Në këtë rast, zyrtari i ngarkuar me dosjen do të ketë barrën të provojë se përndjekja nuk do të përsëritet nëse azilkërkuesi kthehet në vendin e tij/saj.

Për më tepër, në varësi të praktikës vendase, mund të ketë raste ku është vërtetuar se dëmi nuk do të përsëritej, megjithatë përndjekja e mëparshme mund të ketë qenë me **karakter kaq mizor** sa dëmi konsiderohet si i vazhdueshëm. Në situatë të tillë, azilkërkuesit nuk mund t’i kërkohet të kthehet në vendin e përndjekjes sepse kthimi mund t’i shkaktojë shqetësim psikologjik po aq të rëndë sa përndjekja.

Zyrtarët e ngarkuar me dosjet duhet të kenë parasysh se **mungesa e përndjekjes në të shkuarën, nga ana tjetër, nuk do të thotë se nuk ka rrezik për përndjekje në të ardhmen**. Frika e azilkërkuesit mund të jetë e bazuar, pavarësisht përvojave në të shkuarën apo në të tashmen.

Megjithatë, rreziku i të qenët subjekt i përndjekjes, nëse kthehet në vendin e origjinës, duhet të jetë gjithmonë rrezik individual.

Statusi i refugjatit: arsytet për përndjekje [\[kthehu te listë kontrolli\]](#)

Konventa e Gjenevës	Direktiva e Kualifikimit	Legjislacioni i brendshëm
Neni 1, seksioni A, paragrafi 2	Neni 10	

Konventa e Gjenevës parasheh pesë arsye përndjekjeje në bazë të cilave njihet statusi i refugjatit: raca, feja, kombësia, anëtarësia në një grup të caktuar shoqëror dhe bindjet politike. Këto arsye nuk e përjashtojnë njëra-tjetrën dhe një rast i caktuar mund të paraqesë më shumë se një arsye.

Është me rëndësi edhe të theksohet se arsyeja e përndjekjes mund të mos jetë karakteristike aktuale e azilkërkuesit, por mund t'i njihet si e tillë.

Gjithashtu, të gjitha arsytet e përmendura mund të shkaktohen nga një veprim ose mosveprim i azilkërkuesit.

Vlerësimi nuk mund të bazohet në një hamendësim se personi mund ta shmangte përndjekjen duke hequr dorë nga disa praktika të lidhura me këto arsye, për shembull ushtrimi i fesë, shprehja e identitetit gjinor, orientimi seksual ose bindjet politike.

Raca [\[kthehu te listë kontrolli\]](#)

Sipas DK-së, koncepti i **racës** duhet të përmbajë në veçanti konsideratat për:

ngjyrën

prejardhjen

përkatësinë në një grup të caktuar etnik

Ngjyra lidhet me përkufizimin tradicional të racës i cili përdoret për t'iu referuar grupeve më të mëdha të njerëzimit për nga tiparet dhe pamja fizike.

Prejardhja nënkupton grupet e lidhura nga paraardhës të përbashkët siç janë anëtarët e një fisi, klani, kaste ose një komuniteti të caktuar trashëgimie.

Nuk ekziston një përkufizim gjerësisht i pranuar për **grupin etnik**, por në përgjithësi shihet si komunitet (ku përfshihen pakicat dhe/ose popujt indigjenë) me karakteristika të përbashkëta si gjuha, feja, historia e përbashkët, kultura, zakonet dhe doket, mënyra e jetesës ose vendi i banimit.

Etnia është arsye që mund të konsiderohet edhe te raca, edhe te kombësia (shih nënseksionin “Kombësia” më poshtë).

Feja [\[kthehu te listë kontrolli\]](#)

Sipas DK-së, koncepti i **fesë** duhet të përmbajë në veçanti konsideratat për:

të pasurit besim teist, joteist apo ateist

pjesëmarrjen ose mospjesëmarrjen në ceremonitë e kultit, të kremtuara në mënyrë private ose publike, qoftë vetëm apo bashkë me të tjerë

pjesëmarrjen ose mospjesëmarrja në aktet e tjera fetare ose të shprehjes së besimit

pjesëmarrjen ose mospjesëmarrjen në forma sjelljeje personale ose shoqërore të bazuar në besimin fetar ose në kërkesat e tij

Koncepti i fesë është përkufizuar gjerësisht dhe me fleksibilitet në pajtim me DK-në, përfshirë këtu sjelljen sipas besimit fetar ose sipas kërkesave të tij, që mund të jetë sjellja e përditshme, mënyra e jetesës dhe doket e zakonet e një bashkësie.

Në kuadrin e kësaj arsyeje është gjithashtu thelbësore të vlerësohet e drejta për të mos ushtruar besimin fetar, për të qenë ateist ose për të ndërruar besimin fetar. Këtu përfshihet mundësia për të ushtruar fenë në publik, bashkë me të drejtën për të përhapur fenë e vet me anë të konvertimit.

Megjithatë, duhet nënvizuar se ushtrimi i praktikave të dëmshme fetare, të cilat mund të cenojnë integritetin fizik ose psikologjik nuk përfiton nga mbrojtja ndërkombëtare e të drejtave të njeriut dhe nga legjislacioni për refugjatët.

Kombësia [\[kthehu te listë kontrolli\]](#)

Sipas Direktivës së Kualifikimit, koncepti i **kombësisë** nuk duhet të kufizohet te **shtetësia** ose te mungesa e saj, por duhet të përfshijë sidomos **përkatësinë në një grup të karakterizuar nga:**



Sa i takon temës së identitetit etnik, shpesh motivet e kombësisë dhe racës mbivendosen (shih nënseksionin “Raca” më sipër).

Duhet theksuar se përndjekja e një personi për shkak se është pa shtetësi duhet të përfshihet brenda kësaj arsyeje për përndjekje.


Përkatësia në një grup të caktuar shoqëror [\[kthehu te listë kontrolli\]](#)

Koncepti i “grupit të caktuar shoqëror” kuptohet si ndërtim elastik dhe subjekt ndryshimi me kalimin e kohës. Megjithatë, për të ruajtur integritetin e Konventës së Gjenevës dhe DK-së dhe për të siguruar se nuk do t’i kthejë arsyet e tjera në të tepërta, kjo arsye nuk mund të interpretohet si kategori gjithëpërfshirëse.

Sipas Direktivës së Kualifikimit, grupi konsiderohet se formon një grupim të caktuar shoqëror kur:

- anëtarët e grupit kanë mes tyre një karakteristikë të lindur apo një historik të përbashkët që nuk mund të ndryshohet, ose kanë mes tyre një karakteristikë apo besim aq themelor për identitetin ose ndërgjegjen, sa personi nuk duhet të detyrohet të heqë dorë prej kësaj karakteristike ose besimi; dhe
- ky grup ka identitet të dallueshëm në vendin në fjalë sepse perceptohet si i ndryshëm nga shoqëria që e rrethon.

Këto elemente shpjegohen me detaje më poshtë.



Karakteristikat e përbashkëta

Karakteristika e përbashkët duhet të jetë:

- **karakteristikë e lindur** — zakonisht kjo është karakteristikë me të cilën personi lind (p.sh. seksi dhe gjinia), por duhet theksuar se karakteristika nuk ka pse të jetë e përvetshme ose e pandryshueshme; ose
- **historik i përbashkët që nuk mund të ndryshohet** si për shembull gjendja trashëgimore, sfondi shoqëror ose arsimor, apo përvojat e së kaluarës; ose
- një karakteristikë ose besim aq **themelor për identitetin ose ndërgjegjen** sa personi nuk duhet detyruar të heqë dorë prej tij.

Përndjekja nuk mund të jetë elementi i vetëm që i jep përmbajtje një “grupi të caktuar shoqëror” sepse do t’i hiqte kësaj arsyeje çdo përmbajtje kuptimore.

Nuk është e nevojshme që anëtarët e grupit që kanë karakteristika të përbashkëta të njohin njëri-tjetrin, të kenë kohezion apo të kenë ndonjë lidhje. Edhe madhësia e grupit nuk ka asnjë rëndësi.

Perceptimi i identitetit të dallueshëm

Të perceptuarit e grupit si i dallueshëm nuk ka ngjyrim negativ në vetvete.

Perceptimi nga ana e shoqërisë që e rrethon këtë identitet mund të ndikohet nga kultura, zakonet ose tradita. Kjo do të thotë se për të vlerësuar këtë kriter, zyrtarët e ngarkuar me trajtimin e dosjes duhet të marrin në konsideratë me kujdes të dhënat për vendin e origjinës. Kriteri “identiteti i dallueshëm” mund të përmbushet për një vend dhe për një vend tjetër jo.

Ekzistenca e dispozitave penale, të cilat synojnë disa persona në mënyrë specifike, do të na lejonte të arrinim në përfundimin se këta persona duhen konsideruar se formojnë një grup shoqëror të caktuar. Praktikrat e diskriminimit mund të dëshmojnë gjithashtu se kriteri i “identitetit të dallueshëm është përmbushur”.



Konsiderata specifike

Gjinia, identiteti gjinor dhe orientimi seksual

Për qëllim të përkufizimit të një grupi të veçantë shoqëror, duhet t’u jepet konsiderata e duhur çështjeve që lidhen me **gjininë e një azilkërkuesi, madje edhe identitetin gjinor dhe orientimin seksual**, të cilat mund të lidhen me tradita dhe zakone të caktuara ligjore që përkthehen në gjymtimin e organeve gjenitale, sterilizimin e detyruar ose abortin e detyruar, për sa kohë ato lidhen me frikën e bazuar të azilkërkuetit nga përndjekja.

Orientimi seksual/ identiteti seksual. Ky term i referohet kapacitetit të një personi për të ndier tërheqje të thellë emocionale, ndjenjash dhe/ose seksuale dhe/ose për të pasur marrëdhënie intime dhe seksuale me individë të një gjinie tjetër, të së njëjtës gjini ose me individë me më shumë se një gjini. Kjo mund të kuptohet si një vazhdimësi që shkon nga heteroseksualiteti ekskluziv nga njëra anë dhe homoseksualiteti ekskluziv nga ana tjetër, duke pasur në mes biseksualitetin. Kuptimi i orientimit seksual ndryshon shumë nga vendet dhe kulturat e ndryshme.

Orientimi seksual është karakteristikë e lindur e individit dhe pa dyshim që mund të jetë karakteristikë e përbashkët për përkufizimin e një grupi të caktuar shoqëror.

Duhet theksuar se orientimi seksual nuk mund të kuptohet se përfshin aktet e konsideruara si kriminale në përputhje me legjislacionin e brendshëm të Shteteve Anëtare.

Identiteti gjinor. Ky identitet i referohet përjetimit të brendshëm dhe individual që çdo person ndien thellë në vete për gjininë, përjetim që mund të përkojë ose jo me gjininë e caktuar në lindje, përfshirë këtu kuptimin personal për trupin (çka mund të sjellë, nëse zgjidhet lirisht, ndryshimin e pamjes ose funksionit të trupit me mjete mjekësore, kirurgjikale ose të tjera) dhe shprehje të tjera të gjinisë ku përfshihen veshja, të folurit dhe sjelljes.

Gjinia shkon përtej seksit biologjik të njeriut. Ajo është ngrehinë shoqërore, kulturore dhe psikologjike të cilën e krijojnë shoqëritë bazuar te gjinia dhe i referohet “roleve” të paracaktuara të të dy gjinive.


Përndjekja bazuar te gjinia, identiteti gjinor dhe orientimi seksual shpesh përfshin autorë joshtetërorë, përfshirë edhe familjen e azilkërkuarit.

Në nivel shtetëror mund të ekzistojnë orientime të tjera shtesë se cilat grupe përbëjnë grupe të caktuara shoqërore.

Orientime kombëtare

Bindjet politike [\[kthehu te listë kontrolli\]](#)

Sipas Direktivës së Kualifikimit, koncepti i **bindjeve politike** duhet të përfshijë në veçanti:



Një aspekt i rëndësishëm i përkufizimit të dhënë nga DK-ja është ai që bindjet politike mund të jenë arsye për përndjekje jo vetëm nga autorët shtetërorë, por edhe nga ata joshtetërorë. Këto bindje janë më të gjera se opinionet e individit për politikën qeveritare. Ato mund të lidhen me politikën e çdo autori potencial përndjekjeje, me përmbajtjen dhe metodat e promovimit të tyre, përfshirë politikën e autorëve joshtetërorë.



Konsiderata specifike

Shmangia nga shërbimi ushtarak. Një rast specifik, brenda kategorisë së arsyes së përndjekjes për shkak të bindjeve politike, mund të jetë edhe shmangia nga shërbimi ushtarak. Që të konsiderohet si arsye për përndjekje, pjesëmarrja në një veprim ushtarak duhet të jetë në kundërshtim me bindjet e vërteta politike, fetare ose morale të azilkërkuarit. Orientimi për vlerësimin nëse dënimi për këtë shmangie përbën ose jo përndjekje është dhënë më poshtë në konsideratat specifike të nënseksionit “Përndjekja”.

Nëpunësit civilë. Nëpunësit civilë mund të shihen nga autorët e përndjekjes si persona me mendim politik në favor të qeverisë.

Fakti i ikjes nga vendi. Në disa raste, thjesht fakti i ikjes nga vendi i origjinës në mënyrë të parregullt ose të qëndruarit jashtë shtetit mund të shihet nga autoritetet në vendin e origjinës si tregues i të pasurit të një opinioni politik.

Lidhja (për shkak të) [\[kthehu te listë kontrolli\]](#)

Konventa e Gjenevës	Direktiva e Kualifikimit	Legjislacioni i brendshëm
Neni 1, seksioni A, paragrafi 2	Neni 9, paragrafi 3	

Në vetvete aktet e përndjekjes nuk e kualifikojnë personin si refugjat, me përjashtim të rastit kur ato kryhen për një (ose më shumë) prej pesë arsyeve të mësipërme. Duhet të ketë një lidhje shkakësore midis arsyes dhe përndjekjes ose mungesës së mbrojtjes nga kjo përndjekje.

Lidhja mund të jetë si më poshtë.

- **Lidhja me aktet e përndjekjes.** Në këtë rast, frika e azilkërkuesit për përndjekje është e lidhur me racën e tij, fenë, kombësinë, përkatësinë në një grup të caktuar shoqëror ose me bindjen politike (reale ose të hamendësuar).
- **Lidhja me mungesën e mbrojtjes.** Ka raste kur përndjekja mund të bëhet për arsye që nuk përfshihen në përkufizimin e refugjatit, por kur tolerohet, inkurajohet ose nuk parandalohet nga përgjegjësit për mbrojtjen për shkak të njërit prej pesë arsyeve për përndjekje. Pra, kërkesa për të përcaktuar lidhjen do të përmbushej edhe për mungesën e mbrojtjes.

Një azilkërkues mund të mos jetë në gjendje të provojë qëllimet ose arsyet e përndjekjes nga ana e autorëve të përndjekjes. Mund të mos jetë realiste të presësh që autorët e përndjekjes të jenë identifikuar qartë, të kenë marrë përsipër përgjegjësinë e veprimeve të tyre ose të kenë specifikuar arsyet. Megjithatë, nga elementet rrethore mund të jetë e mundur të nxirret një përfundim i përshtatshëm.



Konsiderata specifike

Moria e arsyeve. Mund të ketë arsye të tjera pse është kryer akti i përndjekjes, përveç arsyeve të bazuara te raca, feja, kombësia, anëtarësia në një grup të caktuar shoqëror ose bindjet politike. Është me rëndësi të theksohet se, për të vërtetuar lidhjen shkakësore, aktet nuk kanë nevojë të jenë të motivuara vetëm prej njëres nga pesë arsyet.

Mbrojtja plotësuese [\[kthehu te listë kontrolli\]](#)

Direktiva e Kualifikimit	Legjislacioni i brendshëm
Neni 2, germa “e”	

Siç e thotë edhe vetë emri, mbrojtja plotësuese duhet të shërbejë si formë mbrojtjeje shtesë, e cila plotëson statusin e refugjatit. Do të thotë se **një personi duhet t’i jepet mbrojtje plotësuese vetëm nëse nuk përmbushen kërkesat për statusin e refugjatit.**

Si pikënisje, duhet të sqarohen dy elemente sa i takon mbrojtjes plotësuese: “rreziku real” dhe “dëmi serioz”.

Rreziku real

Rreziku real i referohet standardit të provës që zbatohet në vlerësimin e rrezikut, në rastet e mbrojtjes plotësuese. Ky është vlerësim faktesh dhe interpretohet se përkon me **“shkallën e arsyeshme të probabilitetit”** (shih *Udhëzuesin praktik të EASO-s: Vlerësimi i Provave*).

Dëmi serioz

“Dëmi serioz” karakterizon natyrën dhe shkallën (seriozitetin) e cenimit të të drejtave të personit. Që cenimi të jetë “serioz” duhet të jetë mjaft i rëndë. Për më tepër, nuk flasim për çfarëdo dëmi, diskriminimi ose shkeljeje të drejtash. Dispozitat e mëposhtme të Nenit 15 të DK-së specifikojnë fushëveprimin e “dëmit serioz”:

Dëmi serioz përbëhet nga:

(a) dënimi me vdekje ose ekzekutimi; ose

(b) tortura ose trajtimi a dënimi çnjerëzor ose poshtërues i një azilkërkuesi në vendin e origjinës; ose

(c) kërcënim i serioz dhe individual i jetës së personit ose civilit për shkak të dhunës së verbër në situata konflikti të armatosur ndërkombëtar ose brenda vendit.

Këto lloj dëmsh nënkuptojnë në vetvete ashpërsi të mjaftueshme.

Nuk ka renditje hierarkike ose kronologjike ndërmjet dispozitave të ndryshme. Nëse del se mund të zbatohet më shumë se një dispozitë e Nenit 15 të DK-së, zyrtari i ngarkuar me dosjen duhet të zbatojë atë dispozitë që përkon më mirë me rastin individual. Nuk është për t’u përjashtuar se, në disa raste, mbrojtja plotësuese mund të bazohet shumë mirë në më shumë se një arsye.

Dënimi me vdekje ose ekzekutimi [\[kthehu te listë kontrolli\]](#)

Direktiva e Kualifikimit	Legjislacioni i brendshëm
Neni 15, germa “a”	

Dënimi me vdekje në vetvete dhe në çdo rrethanë konsiderohet një formë dëmi serioz sipas Nenit 15 të DK-së. Nuk është e nevojshme që vendimi të jetë shpallur. Për të mbështetur nevojën për mbrojtje plotësuese mjafton ekzistenca e rrezikut që, pas kthimit në vendin e tij, mbi azilkërkuesin mund të rëndojë dënimi me vdekje.

Siç e sugjeron edhe termi tjetër “ekzekutim”, Neni 15, germa “a”, përmbledh edhe vrasjen e qëllimshme të një personi nga subjekte joshitetërore të cilat ushtrojnë ndonjë lloj autoriteti. Neni mund të përfshijë edhe vrasjen pa gjyq, por duhet të jetë i pranishëm elementi i dënimit të qëllimshëm dhe të formalizuar.



Konsiderata specifike

Moratoriumi për dënimin me vdekje. Në rastet kur ka moratorium për dënimin me vdekje, por dënimin me vdekje në vetvete nuk është shfuqizuar, për azilkërkuesin mund të jetë një rrezik real për dënim me vdekje ose ekzekutim.

Në rast se rreziku real i dënimit me vdekje ose ekzekutimit nuk mund të përjashtohet, mund të ketë gjasa që ai të shkaktojë frikë dhe shqetësim të krahasueshëm me dëmin serioz të parashikuar nga Neni 15, germa “b”, i Direktivës së Kualifikimit.

Alternativat e dënimit me vdekje. Alternativat e dënimit me vdekje si burgimi i përjetshëm, sidomos kur nuk ka perspektivë lirimi, duhet të vlerësohen më tej në lidhje me nevojën për mbrojtje të mundshme në pajtim me Nenin 15, germa “b”, të DK-së.

Konsiderata për përjashtimin. Në disa raste, dënimin me vdekje mund të jetë shpallur për krime të rënda të kryera nga azilkërkuesi ose për akte të tjera të përfshira në arsyet për përjashtim (Nenet 12 dhe 17 të DK-së). Prandaj, edhe pse kriteret e Nenit 15, germa “a”, të DK-së përmbushen, duhet të vlerësohen konsideratat për përjashtimin. Shih [Udhëzuesin Praktik të EASO-s: Përjashtimi](#).

Tortura ose trajtimi apo dënim çnjerëzor ose poshtërues [\[kthehu te listë kontrolli\]](#)

Direktiva e Kualifikimit	Legjislacioni i brendshëm
Neni 15, germa “b”	

Neni 15, germa “b”, i DK-së për nga thelbi përkon me Nenin 3 të KEDNj-së. Për pasojë, jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj) jep orientime me vlerë për të vlerësuar nëse trajtimi mund të hyjë në përkufizimin e Nenit 15, germa “b”, të DK-së dhe koncepteve të tij:



Shpesh jurisprudenca nuk bën dallim të qartë midis torturës dhe trajtimit çnjerëzor ose poshtërues, por në çdo rast kërkon që keqtrajtimi të arrijë një nivel minimal ashpërsie.

Vlerësimi varet nga të gjitha rrethanat e çështjes si p.sh.: kohëzgjatja e keqtrajtimit, pasojat e tij fizike dhe mendore dhe, në disa raste, nga mosha dhe gjendja shëndetësore e personit. Synimi për të cilin është dhënë ky trajtim dhe qëllimi i autorit të tij mund të jenë faktorë të rëndësishëm.

Në rastet kur një trajtim specifik është vlerësuar tashmë se ka arritur në nivel përndjekjeje, duhet të konsiderohet se është arritur shkalla e rëndë e kërkuar nga Neni 15, germa “b”, i DK-së.

Tortura

Tortura është formë e rënduar dhe e qëllimshme e trajtimit mizor, çnjerezor ose poshtërues, së cilës i shtohet edhe stigmatizimi i veçantë.

Sipas instrumenteve përkatëse ndërkombëtare si [Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve a Dënimeve të tjera Mizore, Çnjerezore ose Poshtëruese](#), tortura kuptohet si:

- një **akt i qëllimshëm**;
- i cili shkakton **dhimbje ose vuajtje të rëndë, fizike ose mendore**;
- për **qëllime** të tilla që të përftohet prej tij apo një personi tjetër një informacion ose rrëfim, duke e ndëshkuar atë për një akt që ai ose një person i tretë ka kryer ose dyshohet se ka kryer, ose duke e frikësuar ose detyruar atë ose një person të tretë për ndonjë arsye të bazuar në diskriminim të çfarëdo lloji.

Teksa kjo konventë kërkon më tej që akti i torturës të shkaktohet ose të nxitet nga një funksionar publik, DK-ja e bën të qartë se autorët e dëmit serioz mund të mos jenë subjekte shtetërore (shih seksionin “Autorët e përndjekjes ose të dëmit serioz” më poshtë). Nuk bëhet asnjë përjashtim sa i takon Nenit 15, germa “b”, të DK-së.

Trajtimi apo dënimi çnjerezor ose poshtërues

Dallimi midis torturës dhe trajtimit ose dënimit çnjerezor ose poshtërues është më shumë dallim për nga shkalla sesa nga natyra.

Ato përfshijnë një gamë të gjerë formash të keqtrajtimeve të cilat kapin një nivel të caktuar ashpërsie.

Çnjerezor: ky cilësues i referohet trajtimit ose dënimit i cili shkakton qëllimisht vuajtje të rënda mendore ose fizike (që nuk e arrin pragun e torturës).

Poshtërues: ky cilësues i referohet trajtimit ose dënimit i cili zgjon te viktimat ndjenjat e frikës, ankthit dhe inferioritetit, ndjenja të cilat janë të afta ta poshtërojnë ose zvetënojnë atë.

Duhet theksuar se nuk kërkohet prania e një qëllimi të caktuar. Vlerësimi për të përcaktuar nëse trajtimi ose dënimi është çnjerezor ose poshtërues nënkupton edhe konsideratat subjektive nga ana e viktimës së këtij trajtimi ose dënimi.



Konsiderata specifike

Mungesa e kujdesit të duhur shëndetësor. Tortura ose trajtimi a dënimi çnjerezor a poshtërues duhet të jetë shkakuar me qëllim. Prandaj, dëmi i mundshëm që një azilkërkues, i cili vuan nga një sëmundje e rëndë, mund të përjetojë nëse kthehet në vendin e tij të origjinës nuk bie në fushëveprimin e Nenit 15, germa “b” të DK-së, përjashtoj rastin kur azilkërkuesit i mohohet qëllimisht kujdesi shëndetësor. Kështu, ndërsa mungesa e kujdesit të duhur shëndetësor është konsideratë e rëndësishme në kontekstin e moskthimit (non-refoulement) sipas Nenit 3 të KEDNj-së, kjo mungesë nuk bie në fushëveprimin e trajtimit çnjerezor ose poshtërues të parashikuar nga Neni 15, germa “b”, i DK-së. Kualifikimi për mbrojtje ndërkombëtare sipas DK-së kërkon ekzistencën e autorit të dëmit serioz.

Ndjekja penale dhe dënimet për krimet e zakonshme. Ndjekja penale dhe dënimet për krimet e zakonshme nuk karakterizohen si çnjerezore ose poshtëruese nëse nuk ka rrethana të veçanta rënduese që të mbështesin supozimin se ndjekja penale ose dënimi ishte i padrejtë ose i shpërpjesëtuar. Vlerësimi duhet të marrë parasysh edhe nëse është respektuar e drejta për gjykim të drejtë.

Ja vlen të theksohet se trajtimi ose dënimi çnjerezor a poshtërues mund të vërtetohet edhe në rastet kur azilkërkuesi ka kryer vepra të dënueshme. Nëse në këto raste vërtetohet nevoja për mbrojtje, prapëseprapë konsideratat për përjashtim mund të jenë të vlefshme. Shih [Udhëzuesin Praktik të EASO-s: Përjashtimi](#).


Dënimi me heqje lirie. Shteti duhet të sigurojë se personi i burgosur mbahet në kushte që janë në pajtim me respektin për dinjitetin njerëzor. Mënyrat dhe metodat e zbatimit të masës me burgim nuk duhet ta kthejnë personin në subjekt vuajtjeje dhe vështirësie në shkallë më të lartë se niveli i pashmangshëm i vuajtjes që lidhet me heqjen e lirisë.

Kur vlerësohen kushtet e burgimit mund të merren parasysh së bashku elementet e mëposhtme: numri i personave brenda një hapësire të kufizuar, përshtatshmëria e shërbimeve higjienike, ngrohja, ndriçimi, sistemimi i fjetjes, ushqimi, zbatimja ose kontakti me botën e jashtme.


Kërcënimi i rëndë dhe individual kundër jetës ose personit të civilit për shkak të dhunës së ushtruar pa dallim në situatat e konflikteve të armatosura ndërkombëtare ose të brendshme [\[kthehu te listë kontrolli\]](#)

Direktiva e Kualifikimit	Legjislacioni i brendshëm
Neni 15, germa “c”	

Elementet që duhet të vërtetohen për të zbatuar Nenin 15, germa “c”, të DK-së përfshijnë:



Përveç kësaj, duhet theksuar se zbatimi i Nenit 15, germa “c”, të DK-së varet shumë nga situata e përgjithshme në vendin e origjinës. Prandaj, vlerësimi objektiv dhe i përditësuar i informacionit për vendin e origjinës është element kyç në këtë drejtim.



Konflikt i armatosur ndërkombëtar ose i brendshëm

Siç e ka pohuar Gjykata e Drejtësisë së Bashkimit Evropian (GjDBE) në çështjen *Diakité*, përkufizimi i “konfliktit të armatosur” sipas së drejtës ndërkombëtare humanitare nuk zbatohet në kontekstin e Nenit 15, germa “c”, të Direktivës së Kualifikimit. Prandaj, për të vlerësuar nëse po ndodh një “konflikt i armatosur” (ndërkombëtar ose i brendshëm), nuk është e nevojshme të përbushen kriteret e kërkuara nga e drejta ndërkombëtare humanitare.

Për të vërtetuar se po ndodh një konflikt i armatosur brenda kuptimit të Nenit 15, germa “c”, të Dk-së, mjaftojnë këto dy elemente:

- dy ose më shumë grupe të armatosura, me ose pa përfshirjen e forcave të armatosura shtetërore;
- përplasje midis këtyre grupeve të armatosura.


Nuk është e nevojshme të kryhet vlerësim më vete për fuqinë e përplasjeve të armatosura, nivelin e organizimit të forcave të armatosura të përfshira ose për kohëzgjatjen e konfliktit.

Veç kësaj, në kontekstin e Nenit 15, germa “c”, të DK-së, dallimi midis konfliktit të armatosur “ndërkombëtar” dhe “të brendshëm” nuk është i nevojshëm sepse dispozita zbatohet njëjloj si në situata konflikti të armatosur ndërkombëtar, ashtu dhe në situata konflikti të brendshëm.

Konflikti i armatosur duhet të jetë duke u zhvilluar vetëm në një pjesë të territorit.

Mund të ekzistojnë orientime të cilat cilësojnë situatën në vende të caktuara të origjinës, ose në pjesë të tyre, si konflikt të armatosur ndërkombëtar ose të brendshëm.

Orientime kombëtare



Civilët

Të qenët civil është parakusht i nevojshëm që të mund të përfitohet mbrojtja sipas Nenit 15, germa "c", të DK-së sepse synimi i dispozitës është të mbrojë vetëm ata që nuk marrin pjesë në konflikt. Kjo përfshin zbatimin e mundshëm të Nenit 15, germa "c", të DK-së për ish-luftëtarët të cilët kanë hequr dorë nga aktiviteti i armatosur në mënyrë të sinqertë dhe të përherëshme.

Vlerësimi i nevojave për mbrojtje është vlerësim me natyrë parashikuese. Prandaj, çështja kryesore është të vlerësohet nëse azilkërkuesi do të jetë civil edhe pas kthimit apo jo. Fakti që personi ka marrë pjesë në konflikte në të shkuarën nuk nënkupton automatikisht se Neni 15, germa "c", i DK-së nuk zbatohet për të.

Prandaj, termi "**civil**" konsiderohet se i referohet një personi i cili as nuk është anëtar i ndonjë prej palëve në konflikt, as nuk merr pjesë në armiqësi. Kur vlerësohet shkalla e zbatimit të Nenit 15, germa "c", të DK-së për azilkërkuesit që në të shkuarën kanë marrë pjesë në armiqësi, mund të ishte për shembull me vend të këqyrej nëse pjesëmarrja ka qenë e vullnetshme apo me detyrim. Në rastin e ish-luftëtarëve mund të jenë të përshtatshme konsideratat e përjashtimit (shih [Udhëzuesin Praktik të EASO-s: Përjashtimi](#)).

Duhet theksuar se pjesëmarrja aktive në armiqësi nuk kufizohet vetëm te mbajtja e armëve në mënyrë të hapur, por mund të përfshijë edhe mbështetjen e konsiderueshme logjistike dhe/ose administrative për luftëtarët.

Në rast se ka dyshime nëse personi është civil apo jo, duhet mbajtur një qëndrim i orientuar drejt mbrojtjes dhe personi duhet konsideruar civil.

Mund të ekzistojnë orientime të tjera në nivel kombëtar se kush duhet cilësuar civil ose jo në një konflikt të armatosur të caktuar.

Orientime kombëtare



Dhuna pa dallim


Siç është shprehur GjDBE-ja në çështjen *Elgafaji*, termi "pa dallim" nënkupton se dhuna "**mund të shtrihet gjerësisht mbi njerëzit, pavarësisht rrethanave të tyre personale**". Prandaj, "pa dallim" i referohet natyrës së dhunës dhe jo shkallës së saj.

Veç kësaj, diferenca në nivelin e dhunës pa dallim mund të bëhet si më poshtë:

- I. territoret ku shkalla e dhunës pa dallim arrin në nivele aq të larta për të besuar se, nëse kthehet në vendin në fjalë ose siç mund të jetë rasti në rajonin në fjalë, **thjesht për shkak të pranisë së tij** në territorin e atij vendi ose rajoni, civil do të përballej me rrezikun real të kërcënimit serioz të përmendur në Nenin 15, germa "c", të DK-së; dhe
- II. territoret ku ushtrohet dhunë pa dallim, por nuk arrihet nivel kaq i lartë, dhe për të cilat duhet të paraqiten **elemente individuale shtesë**.

Në kategorinë e parë, përjashtimisht, “vetëm prania” do të konsiderohej e mjaftueshme dhe nuk do të kishte nevojë të vërtetoheshin elementet individuale.

Në kategorinë e dytë, niveli i dhunës pa dallim nuk arrin nivel kaq të lartë dhe vetëm prania e civilit nuk do të kishte automatikisht për pasojë rrezik real të mjaftueshëm për të zbatuar Nenin 15, germa “c”, të Direktivës së Kualifikimit. Në këto raste, sa më shumë të jetë në gjendje azilkërkuesi të tregojë se është cenuar në mënyrë specifike për shkak të faktorëve të veçantë që lidhen me rrethanat e tij personale, aq më e ulët është shkalla e kërkuar e dhunës pa dallim për të zbatuar Nenin 15, germa “c”, të DK-së dhe sa më e lartë të jetë shkalla e dhunës pa dallim që ushtrohet, aq më i ulët është niveli që kërkohet për faktorët shtesë të lidhur me rrethanat personale të azilkërkuesit. Kjo quhet “shkalla lëvizëse”.



Kur përcaktohet nëse dhuna pa dallim po ndodh brenda një territori ose në një pjesë të tij, mund të merren parasysh tregues të ndryshëm:

- numri i incidenteve, shpeshësia dhe dendësia e tyre kundrejt popullsisë vendase;
- natyra e metodave dhe taktikave, përfshirë objektivat;
- numri i viktimave civile (përfshirë të plagosurit);
- prania dhe kapaciteti i secilës palë vepruese në konflikt;
- shtrirja gjeografike e dhunës;
- zhvendosja e popullatës e shkaktuar nga konflikti.

Mund të merren parasysh edhe pasoja të tjera të rëndësishme në jetën e përditshme si: liria e lëvizjes, qasja në shërbimet bazë, shërbimi shëndetësor, arsimi dhe situata e personave të zhvendosur pas kthimit.

Kërcënimi serioz dhe individual

kërcënimin
serioz dhe
individual

Krahasuar me parashikimet e Nenit 15, germa “a” dhe “b”, të DK-së, përkufizimi i dëmit në Nenin 15, germa “c”, të DK-së mbulon një rrezik më të përgjithshëm për azilkërkuesin. Ajo që kërkohet është “kërcënimi serioz dhe individual” (për jetën ose personin e civilit) në vend të akteve individuale të dhunës.

Ky element i Nenit 15, germa “c”, të DK-së duhet parë nën dritën e “shkallës lëvizëse” dhe të dallimeve të ndryshme ndërmjet disa niveleve të dhunës pa dallim.

Ekzistenca e këtij kërcënimi mund të konsiderohet përjashtimisht e vërtetuar aty ku shkalla e dhunës pa dallim që karakterizon konfliktin e armatosur arrin një nivel kaq të lartë, sa të besohet se ekzistojnë arsye të bazuara se, nëse kthehet në atë vend ose sipas rastit në atë rajon, thjesht për shkak të pranisë së tij atje, civilin mund të përballë me rrezikun real të të qenët subjekt i këtij kërcënimi. Aty ku nuk arrihet një nivel aq i lartë dhune pa dallim, do të ishin të nevojshme elemente individualizuese, siç e kërkon edhe formulimi i Nenit 15, germa “c”, të Direktivës së Kualifikimit. Në këtë pikë, disa azilkërkues mund të konsiderohen më shumë si viktime potenciale të dhunës pa dallim, për shkak të rrethanave të tyre personale.

Faktorët si mosha, gjinia, kushtet shëndetësore dhe aftësitë e kufizuara, mungesa e rrethit familjar, gjendja ekonomike dhe afërsia gjeografike me zonat të cilat janë subjekt i dhunës, mund të jenë rrethana të rëndësishme personale për t'u marrë në konsideratë.

ndaj jetës ose personit

Jeta ose personi

Siç është shprehur GjDBE-ja në çështjen *Elgafaji*, Neni 15, germa "c", i DK-së ka një fushëveprim më të gjerë se ai i Nenet 3 të KEDNj-së, prandaj duhet interpretuar në mënyrë të pavarur, por duke respektuar të drejtat e njeriut siç janë garantuar nga KEDNj-ja.

Dëmi që mund të cenojë jetën ose personin e azilkërkuesit nuk kufizohet vetëm te ana fizike, por mund të përfshijë edhe dëmin e rëndë psikologjik që shkaktohet në mënyrë të dukshme nga konflikti.

lidhjen (për shkak të dhunës pa dallim)

Lidhja (për shkak të)

Kërkesa për të pasur një lidhje (për shkak të) i referohet lidhjes shkakësore midis dhunës pa dallim dhe dëmit (kërcënim serioz kundër jetës ose personit të civilit).

Interpretimi i elementeve shkakësore "për shkak të" mund të mos kufizohet te dëmi i shkaktuar drejtpërdrejt nga dhuna pa dallim ose nga veprimet e pjesëmarrësve në konflikt.

Në njëfarë mase mund të përfshijë edhe pasojat e tërthorta të dhunës pa dallim në situatat e konfliktit të armatosur. Për sa kohë ekziston një lidhje e vërtetueshme me dhunën pa dallim, në vlerësim mund të merren parasysh disa pasoja të tërthorta, për shembull dhuna kriminale e përhapur gjerësisht si rezultat i shturjes totale të rendit publik, i shkatërrimit të mjeteve kryesore të jetesës dhe i problemeve të lidhura me furnizimin me ushqime dhe me qasjen në kujdesin shëndetësor.

Nevojat për mbrojtje ndërkombëtare që lindin jashtë vendit të origjinës *sur place* [\[kthehu te listë kontrolli\]](#)

Konventa e Gjenevës	Direktiva e Kualifikimit	Legjislacioni i brendshëm
Neni 1, seksioni A, paragrafi 2	Neni 5	

Kushti i të qenët jashtë vendit të origjinës nuk do të thotë se që të njihet si refugjat ose t'i jepet mbrojtje plotësuese, azilkërkuesi duhet të ketë ikur nga vendi i origjinës për shkak të frikës së bazuar nga përndjekja ose për shkak të rrezikut real për dëm serioz. Rrethanat përkatëse mund të lindin më vonë dhe kjo situatë quhet 'sur place' (ose aty për aty).

Situatat aty për aty ose **sur place**.

<i>Frika e bazuar nga përndjekja ose rreziku real i vuajtjes së dëmeve serioze mund të bazohet në ngjarje që kanë ndodhur që prej largimit të azilkërkuesit nga vendi i origjinës.</i>	Formulimi lidhet me rrethanat e jashtme dhe të pavarura nga azilkërkuesi, të cilat kanë pasoja të drejtpërdrejta të situata e azilkërkuesit dhe krijojnë te ai një frikë të bazuar nga përndjekja ose rrezik real për dëme serioze. Këto ngjarje mund t'i referohen një ndryshimi të rëndësishëm në rrethanat e vendit të origjinës, përfshirë intensifikimin e faktorëve që ekzistonin më parë, pas ikjes së azilkërkuesit nga vendi i origjinës. Megjithatë, nuk është kusht që këto ngjarje të ndodhin në vendin e origjinës. Edhe veprimet e palëve të treta mund të kenë pasoja në situatën individuale të azilkërkuesit.
--	--

<i>Frika e bazuar nga përndjekja ose rreziku real për të vuajtur dëme serioze mund të bazohet në veprimtari në të cilat azilkërkuesi është përfshirë pas largimit të tij nga vendi i origjinës, sidomos kur është vërtetuar se veprimtaritë në fjalë përbëjnë shprehjen dhe vazhdimin e bindjeve ose orientimeve që ai ka shfaqur në vendin e origjinës.</i>	Kur trajtojnë situatat <i>sur place</i> që lidhen me veprimet e azilkërkuesit, zyrtarët e ngarkuar me trajtimin e dosjeve duhet të vlerësojnë nëse autorët e përndjekjes janë në dijeni të bindjeve ose veprimtarive të azilkërkuesit dhe kanë qëndrim kundërshtues ndaj tyre aq sa të zgjojnë te azilkërkuesi frikë të bazuar nga përndjekja ose të përballet me rrezik real për dëme serioze. "Shprehja dhe vazhdimi i bindjeve ose orientimeve që ai ka shfaqur në vendin e origjinës" nuk nënkupton që ato të jenë shprehur më parë në vendin e origjinës. Megjithatë, kjo gjë do të ndihmonte qartë për të vërtetuar nëse bindjet dhe orientimet janë shprehur më parë.
--	---

Pa cenuar Konventën e Gjenevës, Shtetet Anëtare mund të vendosin se një azilkërkuesi i cili depoziton një aplikim të mëvonshëm nuk do t'i jepet normalisht statusi i refugjatit, nëse rreziku i përndjekjes bazohet në rrethanat të cilat azilkërkuesi i ka krijuar vetë që prej largimit nga vendi i origjinës (Neni 5, paragrafi 3, i DK-së). Mundësia e futjes së këtij përjashtimi ka si synim shmangien e abuzimit me regjimin e mbrojtjes ndërkombëtare. Megjithatë, duhet theksuar se vlerësimi për të përcaktuar nëse frika e azilkërkuesit është e bazuar mbetet gjithmonë me natyrë parashikuese dhe se në të gjitha rastet duhet respektuar parimi i moskthimit (non-refoulement).

Legjislacioni dhe orientimet kombëtare

Autorët e përndjekjes ose të dëmit serioz [\[kthehu te listë kontrolli\]](#)

Konventa e Gjenevës	Direktiva e Kualifikimit	Legjislacioni i brendshëm
Neni 1, seksioni A, paragrafi 2	Neni 6	

Tek autorët e përndjekjes ose dëmit serioz përfshihen:

Shteti

- Nocioni i shtetit duhet interpretuar gjerë. Ai përmbledh organe *de jure* dhe *de facto* dhe mund të mbulojë të gjithë funksionarët që ushtrojnë funksione qeveritare, pavarësisht nëse ata i takojnë degës gjyqësore, ekzekutive ose legjislative të qeverisë dhe pavarësisht nivelit ku punojnë.
- Te aktorët shtetërorë të përndjekjes ose dëmit serioz mund të përfshihen edhe: personat ose subjektet e autorizuar të ushtrojnë autoritet qeveritar; individët ose grupet private që veprojnë nën kontrollin ose drejtimin e organeve ose subjekteve të private të autorizuar për të ushtruar autoritet qeveritar; ose përfaqësuesit e shtetit të cilët veprojnë përtej fushëveprimit të autoritetit të tyre ligjor.

Parties or organisations controlling the state or a substantial part of its territory

- Gjatë kontrollit të territorit të shtetit ose të një pjese të madhe të tij, partitë ose organizatat mund të konsiderohen aktorë shtetërorë *de facto* duke ushtruar elemente të autoritetit të qeverisë, në mungesë të autoritetit shtetëror *de jure*.
- Vija ndarëse midis partive ose organizatave që kontrollojnë shtetin, ose një pjesë të konsiderueshme të territorit të tij, dhe aktorëve shtetërorë nuk është gjithmonë e prerë.

Aktorët joshtetërorë

- Nocioni përmbledh të gjithë aktorët joshtetërorë si klanet dhe fiset, grupet rebele, kriminelët dhe anëtarët e familjes.

Autorët e përndjekjes janë element kyç në procesin e përcaktimit të statusit. Përndjekja ose dëmi serioz duhet të përbëhen nga sjellja e një autori specifik.

Mbrojtja në vendin e origjinës [\[kthehu te listë kontrolli\]](#)


Konventa e Gjenevës	Direktiva e Kualifikimit	Legjislacioni i brendshëm
Neni 1, seksioni A, paragrafi 2	Neni 7	

Mbrojtja ndërkombëtare është detyesore kundrejt mbrojtjes së disponueshme në vendin e origjinës. Për këtë arsye, vlerësimi i mbrojtjes së disponueshme në vendin e origjinës është hap i detyruar në analizën e nevojave për mbrojtje ndërkombëtare, hap i cili duhet ndërmarrë nëse zyrtari i ngarkuar me dosjen ka vërtetuar më parë se ekziston një rrezik real për përndjekje ose dëm serioz në rast se azilkërkuesi kthehet në vendbanimin e tij në vendin e origjinës.

Së pari, zyrtari i ngarkuar me dosjen duhet të konsiderojë nëse mbrojtja do të jetë e disponueshme në vendin e banimit brenda vendit të origjinës. Në rast se kjo mbrojtje nuk është e disponueshme, mund të shihet ekzistenca e një zone tjetër të sigurt brenda vendit të origjinës.

Ekzistenca ose mosekzistenca e mbrojtjes nuk ka pse të lidhet me arsyet për përndjekje. Paaftësia dhe pamundësia e dukshme për të ofruar mbrojtjen e duhur tregon mungesë mbrojtjeje. Arsyet dhe motivet diskriminuese nga ana e përgjegjësve për mbrojtjen nuk janë parakusht. Megjithatë, duhet nënvizuar se rastet ku mungesa e mbrojtjes është e qëllimshme mund të konsiderohen përndjekje ose dëm serioz.

Tabela më poshtë ilustron elementet detyruese që duhen marrë në konsideratë kur kryhet vlerësimi i ekzistencës së mbrojtjes nga përndjekja ose dëmi serioz.



Përgjegjësit për mbrojtjen [\[kthehu te listë kontrolli\]](#)

Lista e përgjegjësve për mbrojtjen është **shteruese**.

- Shteti

Zakonisht është Shteti përgjegjësi kryesor për mbrojtjen. Ai përmbledh të gjitha organet që ushtrojnë funksione legjislative, ekzekutive, gjyqësore apo çfarëdo funksioni tjetër dhe vepron në të gjitha nivelet: në atë qendror, federal, rajonal, provincial apo vendor.

Në disa raste enteve private mund t'u jepet fuqi shtetërore dhe të bëhen përgjegjëse për të dhënë mbrojtje nën kontrollin e Shtetit. Kjo gjë duhet bërë në bazë të një mase të marrë nga Shteti.

Që të konsiderohet përgjegjës për mbrojtjen, Shteti ka detyrën të kontrollojë gjithë territorin e vendit të origjinës ose të paktën një pjesë të madhe të tij. Në disa raste, Shteti si përgjegjës për mbrojtjen mund të marrë ndihmë nga partitë dhe organizatat, madje edhe nga organizatat ndërkombëtare, për të përmbushur plotësisht rolin e tij mbrojtës. Megjithatë, nuk duhet cenuar kontrollin e Shtetit mbi territorin ose mbi një pjesë të rëndësishme të tij.

Shteti: ka vullnet

Shteti nuk ka vullnetin të ofrojë mbrojtje, sidomos kur ai vetë është aktor i përndjekjes ose dëmit serioz ose kur ai i toleron këto akte.

Aty ku shteti ose përfaqësuesit e tij janë autorë të përndjekjes ose dëmit serioz, duhet të supozohet se për azilkërkuesin nuk jepet mbrojtje efikase. Megjithatë, ky supozim është i kundërshtueshëm dhe mund të zbatohen disa përjashtime (p.sh. kur kërcënimi është nga një autoritet vendor dhe autoriteti qendror ka vullnetin dhe aftësinë për të ofruar mbrojtje).

Shteti: është i aftë

Thjesht vullneti për të mbrojtur nuk mjafton kur mungon aftësia për të mbrojtur.

Shteti nuk është i aftë të ofrojë mbrojtje nëse nuk ka fuqinë dhe burimet e nevojshme për ta dhënë mbrojtjen.


Në këtë kuadër, vëmendje e veçantë u duhet dhënë situatave ku në vendin e origjinës së fundmi ka ndodhur ndryshim pushteti ose vendi është në situatë të jashtëzakonshme.

Këto kushte duhen përmbushur së bashku. Mbrojtja nuk mund të konsiderohet se i është dhënë azilkërkuesit nëse Shteti ka vullnetin, por jo aftësinë për të dhënë mbrojtjen, ose nëse ka aftësinë, por jo vullnetin për ta dhënë.

Paaftësia dhe/ose mungesa e vullnetit të Shtetit për të dhënë mbrojtjen mund të jetë e veçantë për rastin individual të azilkërkuesit ose me natyrë të përgjithshme, çka vlen edhe për azilkërkuesin.

• Partitë dhe organizatat, përfshirë këtu organizatat ndërkombëtare

Partitë dhe organizatat mund të konsiderohen përgjegjëse për mbrojtjen, me kusht që të përmbushin kërkesat e mëposhtme së bashku.




Për të konsideruar se partitë dhe organizatat kontrollojnë territorin e një shteti ose një pjesë të rëndësishme të tij, duhet vërtetuar se ato ushtrojnë funksionet shtetërore përkatëse. Ky vlerësim duhet kryer bashkë me aftësinë e tyre ekzistuese për të dhënë mbrojtje, e cila duhet të jetë efektive dhe me natyrë të përhershme.

Vullneti dhe aftësia e partive dhe organizatave për të dhënë mbrojtjen duhet të çmohet sipas të njëjtave standarde që zbatohen për mbrojtjen e dhënë nga Shteti.

Cilësia e mbrojtjes

Mbrojtja në vendin e origjinës duhet të përmbushë së bashku këto tri kushte.



► E efektshme [kthehu te listë kontrolli]

Mbrojtja përgjithësisht ofrohet kur përgjegjësit për mbrojtjen marrin masa të arsyeshme për të parandaluar përndjekjen ose vuajtjen e një dëmi serioz, *ndër të tjera*, duke zbatuar një sistem efikas ligjor për zbulimin, ndjekjen penale dhe dënimin e veprimeve që përbëjnë përndjekje ose dëm serioz dhe kur azilkërkuessit i jepet një mbrojtje e tillë.

Vlerësimi për të përcaktuar nëse përgjegjësi për mbrojtjen ndërmerr **masa të arsyeshme** është çështje praktike dhe ka të bëjë me masat që mund të merren në mënyrë të arsyeshme për të parandaluar përndjekjen ose dëmin serioz nga të cilat ka frikë azilkërkuessit. Se cilat masa mund të cilësohen të arsyeshme varet nga shkalla e seriozitetit të dëmit të cilit i frikësohet azilkërkuessit. Disa nivele keqtrajtimi nuk mund të përjashtohen edhe kur merren masa të arsyeshme për të parandaluar përndjekjen ose dëmin serioz.

Veprimet e përndjekjes ose veprimet që shkaktojnë dëm serioz normalisht janë objekt i legjisllacionit penal për shkak të ashpërsisë së tyre. Vetëm zbulimi, ndjekja penale dhe dënimet e veprimeve që përbëjnë përndjekje ose dëm serioz, pasi janë kryer këto veprime, nuk përmbush kërkesat për një mbrojtje të efektshme. Përgjegjësit për mbrojtjen duhet të marrin masa të arsyeshme për të parandaluar këto veprime të dëmshme dhe të ulin rrezikun e kryerjes së tyre.

Kur bëhet vlerësimi nëse mund të jepet mbrojtje e efektshme, mund të merren parasysh elemente si provat dokumentare për respektimin e të drejtave të njeriut, korrupsioni, mjaftueshmëria e burimeve, procedurat e zbatimit të ligjit dhe pavarësia e gjyqësorit.

► Me natyrë të përhershme [kthehu te listë kontrolli]

Meqenëse vlerësimi i nevojës për mbrojtje ndërkombëtare është me natyrë parashikuese, është thelbësor vlerësimi nëse mbrojtja në vendin e origjinës është me natyrë të përhershme ose të përkohshme.

Kujdes i veçantë duhet bërë kur vlerësohet ky element në lidhje me mbrojtjen e dhënë nga partitë ose organizatat, përfshirë këtu organizatat ndërkombëtare, të cilat kanë kontroll mbi Shtetin ose mbi një pjesë të rëndësishme të territorit të tij, meqenëse kontrolli i tyre, normalisht, do të ishte me natyrë të përkohshme.

► E arritshme [kthehu te listë kontrolli]

Nëse mbrojtja është e arritshme nga azilkërkuessit në vendin e origjinës, duhet të vlerësohet së bashku nën dritën e pengesave ligjore dhe praktike që ai has për të marrë mbrojtje. Këto pengesa mund të lidhen me situatën personale të azilkërkuessit, me diskriminimin, barrierat kulturore, pozicionin e autorit të përndjekjes ose dëmit serioz etj.

Kur autori i përndjekjes ose dëmit serioz është Shteti, mund të supozohet se mbrojtja nuk është e arritshme. Kjo lidhet me kërkesën e vullnetit për mbrojtje nga ana e Shtetit.

Që të arrihet në përfundimin se mbrojtja nuk është e arritshme, duhet vërtetuar se:

- azilkërkuesi ka kërkuar më kot mbrojtje nga autoritetet kompetente në vendin e origjinës; ose
- azilkërkuesi nuk do ta merrte mbrojtjen edhe nëse do ta kishte kërkuar, p.sh. në rastin kur mbrojtja përgjithësisht nuk është e disponueshme ose kur kërkesa do të ishte pa rezultat ose edhe e rrezikshme.

Megjithatë, shterimi i mjeteve ligjore brenda vendit të origjinës nuk është parakusht për të vërtetuar mungesën e qasjes në mbrojtjen nga përndjekja ose dëmi serioz. Rrethanave personale të azilkërkuesit u duhet dhënë vëmendja e duhur, sidomos nëse ai ka përjetuar keqtrajtime nga përgjegjësit për mbrojtjen ose përgjegjësi për mbrojtjen nuk e ka mbrojtur më parë azilkërkuesin nga përndjekja ose dëmi serioz.

Alternativa ndaj mbrojtjes brenda vendit [\[kthehu te listë kontrolli\]](#)

Konventa e Gjenevës	Direktiva e Kualifikimit	Legjislacioni i brendshëm
Neni 1, seksioni A, paragrafi 2	Neni 8	

Në rast se mbrojtja nuk është e disponueshme në zonën ku banon azilkërkuesi në vendin e origjinës, duhet shqyrtuar ekzistenca e një pjese tjetër të sigurt brenda atij vendi.

Për rrjedhojë, zyrtari i ngarkuar me dosjen mund të përcaktojë se azilkërkuesi nuk ka nevojë për mbrojtje ndërkombëtare nëse ekziston e pjesë të vendit të tij të origjinës ku ai nuk ka frikë të bazuar nga përndjekja dhe nuk është në rrezik real që të vuajë dëme serioze ose nëse ka qasje në mbrojtjen nga përndjekja ose dëmi serioz.

Zyrtari i ngarkuar me dosjen ka detyrën të provojë se mbrojtja e brendshme është e disponueshme në atë pjesë të veçantë të vendit të origjinës. Zyrtari i ngarkuar me dosjen duhet ta identifikojë këtë zonë.

Për të përcaktuar se mbrojtja e brendshme është e disponueshme në një **pjesë të veçantë** të vendit të origjinës së azilkërkuesit, duhet të përmbushen tri kritere së bashku.

Kjo pjesë e vendit është e **sigurt** për azilkërkuesin.

Azilkërkuesi ka **qasje** në këtë pjesë të vendit.

Ka arsye të pritë që azilkërkuesi të vendoset aty.

Nuk është kusht që para se të kërkojë mbrojtje ndërkombëtare azilkërkuesi të ketë shteruar mundësitë për të marrë mbrojtje në një pjesë tjetër të vendit të origjinës. Vlerësimi ka për synim të përcaktojë nëse kjo alternativë është e disponueshme në momentin e marrjes së vendimit.

► Siguria në një pjesë të vendit të origjinës [\[kthehu te listë kontrolli\]](#)

Një zonë është e sigurt për azilkërkuesin ose sepse në këtë zonë ai nuk ka frikë të bazuar nga përndjekja ose dëm serioz, ose sepse në atë pjesë të vendit ai ka qasje në mbrojtjen nga përndjekja ose dëmi serioz.

<p>Mungesa e përndjekjes ose dëmit serioz</p>	<ul style="list-style-type: none"> • mungesa e përndjekjes ose dëmit serioz që e ka burimin në zonën e origjinës së azilkërkuesit: këtu duhet shqyrtuar se sa mundësi ka autori i përndjekjes ose dëmit serioz ta arrijë këtë zonë; <p style="text-align: center;">dhe</p> <ul style="list-style-type: none"> • mungesa e formave të reja potenciale të përndjekjes ose dëmit serioz. <p>Në rast se Shteti është autor i përndjekjes ose dëmit serioz, normalisht nuk do të kishte zonë të sigurt brenda vendit të origjinës sepse shteti përgjithësisht ka kompetencë mbi gjithë territorin e tij.</p>
<p>ose</p>	
<p>Ekzistenca e mbrojtjes nga përndjekja ose dëmi serioz</p>	<p>Mbrojtja në zonën në fjalë duhet të përmbushë të njëjtët elemente detyruese me ato të kërkuara për mbrojtjen nga përndjekja ose dëmi serioz në zonën ku azilkërkuesi banon brenda vendit të origjinës (shih nënseksionin “Cilësia e mbrojtjes”).</p> <p>Në rast se Shteti është autori i përndjekjes ose dëmit serioz, supozohet se azilkërkuesi nuk mund të ketë mbrojtje efektive pasi Shteti ka kompetencë mbi gjithë territorin.</p> <p>Në rast se përndjekja ose dëmi serioz i shkaktuar nga autorë joshtetërorë pranohet ose tolerohet nga Shteti, duhet analizuar ndikimi i autorëve joshtetërorë në zonën e konsideruar për mbrojtjen alternative ndaj asaj të brendshme.</p>

► **Qasja në pjesë të vendit të origjinës** [\[kthehu te listë kontrolli\]](#)

Që të arrihet në përfundimin se në vendin e origjinës ka alternativë ndaj mbrojtjes së brendshme, nuk mjafton që zyrtari i ngarkuar me dosjen të identifikojë një pjesë të sigurt të atij vendi. Azilkërkuesi duhet të jetë në gjendje të udhëtojë pa rrezik dhe në mënyrë të ligjshme drejt asaj pjese të vendit dhe të pranohet atje.



- **Të udhëtojë pa rrezik.** Me këtë kuptojmë se ekziston një rrugë e sigurt gjatë të cilës azilkërkuesi mund të udhëtojë në mënyrë praktike pa shumë vështirësi, në mënyrë që të hyjë në zonën e sigurt brenda vendit të origjinës pa rreziqe serioze.
- **Të udhëtojë në mënyrë të ligjshme.** Nuk ka pengesa ligjore që të pengojnë azilkërkuesin të udhëtojë drejt zonës së sigurt.
- Në veçanti, nëse azilkërkuesit i duhet të kalojë përmes një vendi të tretë për të hyrë në zonën e sigurt, ai duhet të jetë në gjendje ta bëjë këtë ligjërisht.
- **T'i lejohet hyrja.** Azilkërkuesit i lejohet të hyjë në zonën e sigurt nga përgjegjësit që e kanë nën kontroll.

► **Azilkërkuesi e gjen të arsyeshme të vendoset në një pjesë të vendit të origjinës** [\[kthehu te listë kontrolli\]](#)

Prova e arsyes mbështetet në **qasjen e bazuar mbi të drejtat**. Duhet të garantohen veçanërisht nevojat bazë, përfshirë ndër të tjera, nevojat për ushqim, strehim dhe higjienë. Përveç kësaj, duhet t'i jepet vëmendja e duhur mundësisë që personi të sigurojë jetesën për veten dhe familjen e tij, kujdesin shëndetësor bazë dhe arsimimin për fëmijët e tij.

Vlerësimi për të kuptuar nëse azilkërkuesi e gjen të arsyeshme të vendoset në atë pjesë të vendit duhet të marrë parasysh rrethanat individuale të azilkërkuesit si: mosha, gjinia, gjendja shëndetësore, sfondi shoqëror dhe arsimor, lidhjet familjare dhe shoqërore, gjuha, identiteti gjinor, orientimi seksual etj.

Orientime kombëtare**Mosdashja e azilkërkuesit për të përfituar mbrojtje në vendin e origjinës**

Në rast se mbrojtja në vendin e origjinës është e disponueshme, mund të ketë raste ku azilkërkuesi nuk dëshiron të përfitojë nga kjo mbrojtje, bazuar në arsye të justifikuara.

Mosdashja për të përfituar mbrojtje në vendin e origjinës (madje edhe mbrojtjen në një pjesë tjetër të sigurt në vendin e origjinës) duhet të lidhet me frikën e tij nga përndjekja ose me rrezikun për dëm serioz.


Përjetimi i ngjarjeve të shkuara traumatike dhe pasojat e tyre afatgjata përbëjnë justifikim të fortë për mosdashjen e azilkërkuesit për të përfituar mbrojtje në vendin e origjinës.

DIAGRAME

- ▶ *Udhëzime hap pas hapi për zyrtarin e ngarkuar me dosjen gjatë shqyrtimit të aplikimit individual për mbrojtje ndërkombëtare.*

1

Konsiderata paraprake: fushëveprimi personal dhe territorial



2a

Përndjekja

A është përndjekja së cilës i trembet azilkërkuesi shkelje aq e rëndë e të drejtave të njeriut sa të marrë formën përmendur ndër të tjera në Nenin 9(2) të DK-së?

jo

A përbën trajtimi shkelje të një të drejte të pashmangshme të njeriut ose shkelje mjaft të rëndë të një të drejte tjetër themelore të njeriut?

jo

A mundet që trajtimi të konsiderohet si akumulim i disa masave të ndryshme, pasojat e të cilave mund të ndikojnë te azilkërkuesi në mënyrë të ngjashme?

jo


po

po

po


Trajtimi kualifikohet si përndjekje — vazhdoni te hapi 2b

Trajtimi nuk kualifikohet si përndjekje — vazhdoni te hapi 3




2b

Frika e bazuar



2c


Arsyet për përndjekje



3

Mbrojtja plotësuese

A ka ndonjë shkallë të arsyeshme gjasash që azilkërkuesi të përballlet me ndonjë lloj prej këtyre dëmeve serioze?



4

Mbrojtja në vendin e origjinës

A janë aktorë shteti ose partitë ose organizatat, përfshirë organizatat ndërkombëtare, që kontrollojnë shtetin ose një pjesë të konsiderueshme të territorit të shtetit?

po

A është e efektshme mbrojtja që jenë në gjendje të japin ata?

po

A është e përhershme mbrojtja që jenë në gjendje të japin ata?

po

A është e arritshme për azilkërkuesin mbrojtja që jenë në gjendje të japin ata?

po

Nuk ka nevojë për mbrojtje ndërkombëtare

jo

jo


jo

jo

Nuk ka mbrojtje në zonën e banimit të azilkërkuesit — vazhdoni te hapi 5

5

Alternativa e mbrojtjes së brendshme



REFERENCAT

- ▶ *Referencat në legjislacion, në jurisprudencën përkatëse ose në burimet e tjera shtesë.*
- ▶ *Përdorni hapësirat e zbrazëta për të shënuar legjislacionin dhe jurisprudencën e brendshme.*

Shkurtime dhe lidhje të dobishme

- **DK** — Direktiva 2011/95/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 13 dhjetor 2011 “Standardet për kualifikimin e shtetasve të vendeve të treta ose personave pa shtetësi si përfitues të mbrojtjes ndërkombëtare, për një status uniform për refugjatët ose për personat e pranueshëm për mbrojtje plotësuese dhe për përmbajtjen e mbrojtjes së dhënë”
- **DPA** — Direktiva 2013/32/BE e Parlamentit evropian dhe e Këshillit, datë 26 qershor 2013, për procedurat e përbashkëta për dhënien dhe heqjen e mbrojtjes ndërkombëtare
- **GjDBE** — Gjykata e Drejtësisë së Bashkimit Evropian
- **GjEDNj** — Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
- **GjND** — Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë
- **KEDNj** = Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut
- **KGj** — 1951 Konventa e Gjenevës dhe Protokollit i vitit 1967 për statusin e refugjatit

Burime të tjera

Manuali dhe udhëzimet e UNHCR-së për procedurat dhe kriteret për përcaktimin e statusit të refugjatit sipas Konventës së vitit 1951 dhe Protokollit të vitit 1967 për statusin e refugjatit, dokumente orientuese dhe politike si dhe përfundimet e Komitetit Ekzekutiv dhe të Komitetit të Përhershëm të UNHCR-së mund të gjenden **këtu**.

Referencat ligjore dhe jurisprudenca përkatëse

Kjo listë me referenca ligjore dhe jurisprudencë nuk përbën një mjet referimi shterues. Ajo ka si synim thjesht t’i japë zyrtarit të ngarkuar me dosjen orientime praktike, duke e drejtuar te disa dispozita dhe jurisprudencë nga më të rëndësishmet.

Referencat e mëposhtme janë të organizuara sipas temës. Aty ku ka qenë e mundur, jurisprudenca dhe instrumentet e tjera ligjore janë vënë me hiperlidhje për lehtësi reference.

Parime të përgjithshme

Referenca ligjore	Jurisprudenca
Neni 1, seksioni A, paragrafi 2 i KGj-së	<ul style="list-style-type: none"> • GjDBE, H. N. kundër Minister for Justice, Equality and Law Reform, Ireland, Attorney General, çështja C-604/12, vendim i datës 8 maj 2014, EU:C:2014:302, paragrafi 35 (<i>parësia e statusit të refugjatit</i>)
Neni 2, germa “d” dhe “f” i DK-së	<ul style="list-style-type: none"> • GjDBE, M. M. kundër Minister for Justice, Equality and Law Reform, Ireland, Attorney General, çështja C-277/11, vendim i datës 22 nëntor 2012, EU:C:2012:744, paragrafi 64 (<i>etapat në procesin e vendimmarrjes</i>)
Neni 4, paragrafi 3, i DK-së	
Legjislacioni i brendshëm	Jurisprudenca vendase

Fushëveprimi personal dhe territorial

Referencat ligjore	Jurisprudenca
<p>Protokolli i Konventës së Gjenevës i vitit 1967 për statusin e refugjatit</p> <p>Neni 2, germa “d” dhe “f”, i DK-së</p> <p>Konventa për statusin e personave pa shtetësi, 360 UNTS 117, 28 shtator 1954</p> <p>Protokolli (Nr 24) për azilin e shtetasve të Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian</p>	<ul style="list-style-type: none"> • GjND, <i>Nottebohm Case (Lihtenshtajn kundër Guatemalës)</i>, vendim i datës 6 prill 1955, <i>Faza e dytë, ICJ Reports 1955</i>, faqet 23-24 (dhënia e kombësisë) • GjDBE, <i>X dhe X kundër État belge, çështja C-638/16 PPU</i>, vendim i datës 7 mars 2017, <i>EU:C:2017:173</i>, paragrafët 49 dhe 51 (fushëveprimi territorial i DK-së)
Legjislacioni i brendshëm	Jurisprudenca vendase

Statusi i refugjatit: frikë e bazuar nga përndjekja

Referencat ligjore	Jurisprudenca
<p>Neni 1, seksioni A, paragrafi 2, i KGj-së</p> <p>Neni 9 i DK-së</p> <p>Neni 4, paragrafi 4, i DK-së</p> <p>Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, Asambleja e Përgjithshme me OKB-së, Rezoluta 217 (VIII), 10 dhjetor 1948</p> <p>Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, 999 UNTS 171, 16 dhjetor 1966</p> <p>Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor, 660 UNTS 195, 7 mars 1966</p> <p>Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, 1249 UNTS 13, 18 dhjetor 1979</p> <p>Konventa për të Drejtat e Fëmijës, 1577 UNTS 3, 20 nëntor 1989</p>	<ul style="list-style-type: none"> • GjDBE, <i>Andre Lawrence Shepherd kundër Bundesrepublik Deutschland, çështja C-472/13</i>, vendim i datës 26 shkurt 2015, <i>EU:C:2015:117</i>, paragrafët 25-26 (vlerësimi individual i përndjekjes), paragrafët 46, 49 dhe 52-56 (dezertimi nga ushtria) • GjDBE, <i>Bundesrepublik Deutschland kundër Y dhe Z, çështjet e bashkuara C-71/11 dhe C-99/11</i>, vendim i datës 5 shtator 2012, <i>Dhoma e Madhe, EU:C:2012:518</i>, paragrafi 57, paragrafët 60-67 (shkelje e rëndë e së drejtës për liri fetare), paragrafi 72 (seriozitet i mjaftueshëm për ta cilësuar përndjekje), paragrafët 78-80 (gjetja e bazuar) • GjDBE, <i>Minister voor Immigratie en Asiel kundër X dhe Y dhe Z kundër Minister voor Immigratie en Asiel, çështje të bashkuara C-199/12 to C-201/12</i>, vendim i datës 7 nëntor 2013, <i>EU:C:2013:720</i>, paragrafët 53-61 (seriozitet i mjaftueshëm për ta cilësuar përndjekje, ndjekja penale e akteve homoseksuale), paragrafët 63-64 (përndjekjet e pësuar në të shkuarën), paragrafët 73-76 (baza e frikës)

Referencat ligjore	Jurisprudenca
<p>Protokolli alternativ i Konventës për të Drejtat e Fëmijës “Për përfshirjen e fëmijëve në konfliktet e armatosura” i 25 majit 2000</p> <p>Protokolli alternativ i Konventës për të Drejtat e Fëmijës “Për shitjen e fëmijëve, prostitucionin e fëmijëve dhe pornografinë me fëmijë” i 25 majit 2000</p> <p>Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, 2515 UNTS 3, 13 dhjetor 2006</p> <p>Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore i vitit 1966, 993 UNTS 3, 16 dhjetor 1966</p> <p>Karta Sociale Evropiane e vitit 1961, STE Nr. 35, 18 tetor 1961 dhe Karta Sociale Evropiane e ndryshuar, STE Nr. 163, 3 maj 1996</p>	
Legjislacioni i brendshëm	Jurisprudenca vendase

Arsyet për përndjekje: raca

Referencat ligjore	Jurisprudenca
<p>Neni 1, seksioni A, paragrafi 2 i KGj-së</p> <p>Neni 10, paragrafi 1, germa “a”, i DK-së</p> <p>Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor, 660 UNTS 195, 7 mars 1966</p>	<ul style="list-style-type: none"> • GjEDNJ, <i>Khamrakulov k. Russia</i>, kërkesa nr. 68894/13, 16 prill 2015, paragrafët 66 dhe 67 (përndjekja për shkak të origjinës etnike) • GjEDNJ, <i>A.A. k. France</i>, kërkesa nr. 18039/11, vendim i datës 15 prill 2015, paragrafi 58 (përndjekja për shkak të origjinës etnike) • GjEDNJ, <i>A.F.k. France</i>, kërkesa nr. 80086/13, vendim i datës 15 prill 2015, paragrafët 50-52 (përndjekja për shkak të origjinës etnike) • GjEDNJ, <i>S.H. k. the United Kingdom</i>, kërkesa nr. 19956/06, vendim i datës 15 qershor 2010, paragrafi 70 (diskriminimi racial) • GjEDNJ, <i>Salah Sheekh k. the Netherlands</i>, kërkesa nr. 1948/04, vendim i datës 11 janar 2007, paragrafi 148 (pakicë etnike) • GjEDNJ, <i>Cyprus k. Turkey</i>, kërkesa nr. 25781/94, vendim i datës 10 maj 2001, <i>Dhoma e Madhe</i>, paragrafi 306 (diskriminim racial)
Legjislacioni i brendshëm	Jurisprudenca vendase

Arsyet për përndjekje: feja

Referencat ligjore	Jurisprudenca
<p>Neni 1, seksioni A, paragrafi 2 i KGj-së</p> <p>Neni 10 , germa “b”, i DK-së</p>	<ul style="list-style-type: none"> • GjDBE, <i>Bundesrepublik Deutschland kundër Y dhe Z, çështje të bashkuara C-71/11 dhe C-99/11, vendim i datës 5 shtator 2012, Dhoma e Madhe, EU:C:2012:518</i>, paragrafi 80 (<i>nuk mund të pritët që azilkërkuesi të heqë dorë nga praktikat e tij fetare</i>) • GjEDNj, <i>F.G. k. Sweden, kërkesa nr. 43611/11, vendim i datës 23 mars 2016</i>, paragrafët 123-124 (<i>konvertimi i fesë</i>) • GjEDNj, <i>M.K.N. k. Sweden, kërkesa nr. 72413/10, vendim i datës 27 qershor 2013</i>, paragrafët 32-44 (<i>përkatësia fetare</i>)
Legjislacioni i brendshëm	Jurisprudenca e brendshme

Arsyet për përndjekje: kombësia

Referencat ligjore	
<p>Neni 1, seksioni A, paragrafi 2 i KGj-së</p> <p>Neni 10, germa “c”, i DK-së</p>	
Legjislacioni i brendshëm	Jurisprudenca vendase

Arsyet për përndjekje: anëtarësia në një grup të caktuar shoqëror

Referencat ligjore	Jurisprudenca
<p>Neni 1A, paragrafi 2, i KGj-së</p> <p>Neni 10, germa “d”, i DK-së</p> <p>Deklamimi 30 i DK-së</p>	<ul style="list-style-type: none"> • GjDBE, <i>Minister voor Immigratie en Asiel k. X and Y and Z v Minister voor Immigratie en Asiel, çështje të bashkuara C-199/12 deri C-201/12, vendim i datës 7 nëntor 2013, EU:C:2013:720</i>, paragrafët 45-49 (<i>përkufizimi i grupeve të caktuara shoqërore</i>), paragrafët 53-61 (<i>kriminalizimi i akteve homoseksuale</i>), paragrafët 70-76 (<i>nuk mund të pritët që azilkërkuesi të fshehtë homoseksualitetin ose të japë prova rezervimi në shprehjen e orientimit të tij seksual</i>)
Legjislacioni i brendshëm	Jurisprudenca vendase

Arsyet për përndjekje: bindjet politike

Referencat ligjore	
Neni 1A, paragrafi 2, i KGj-së	
Neni 10, germa “d”, i DK-së	
Legjislacioni i brendshëm	Jurisprudenca vendase

Lidhja (për shkak të)

Referencat ligjore	
Neni 1A, paragrafi 2, i KGj-së	
Neni 9, paragrafi 3, i DK-së	
Legjislacioni i brendshëm	Jurisprudenca vendase

Mbrojtja shtesë: rreziku real për dëm serioz

Referencat ligjore	Jurisprudenca
Neni 2, germa “f”, i DK-së	<ul style="list-style-type: none"> • GjDBE, <i>Meki Elgafaji and Noor Elgafaji kundër Staatssecretaris van Justitie, çështja C-465/07, vendim i datës 17 shkurt 2009</i>, EU:C:2009:94, paragrafi 40 (dëmi serioz i pësuar në të shkuarën) • GjEDNj, <i>F.G. k Sweden, kërkesa nr. 43611/11, vendim i datës 23 mars 2016</i>, paragrafi 115 (vlerësimi i rrezikut real) • GjEDNj, <i>Auad k.. Bulgaria, kërkesa nr. 46390/10, vendim i datës 11 tetor 2011</i>, paragrafi 99(c) (vlerësimi i rrezikut real) • GjEDNj, <i>Saadi k.. Italy, kërkesa nr. 37201/06, vendim i datës 28 shkurt 2008</i>, paragrafi 130 (vlerësimi i rrezikut real); paragrafi 140 (standardi i provës) • GjEDNj, <i>Vilvarajah and Others k.. The United Kingdom, 45/1990/236/302-306, vendim i datës 26 shtator 1991</i>, paragrafi 111 (standardi i provës)
Legjislacioni i brendshëm	Jurisprudenca vendase

Mbrojtja plotësuese: dënimi me vdekje ose ekzekutimi

Referencat ligjore	Jurisprudenca
<p>Neni 15, gema “a”, i DK-së</p> <p>Neni 2 i KEDNj-së</p> <p>Protokolli nr. 6 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore në lidhje me Heqjen e Dënimit me Vdekje</p> <p>Protokolli nr. 13 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore në lidhje me Heqjen e Dënimit me Vdekje në çdo Rrethanë</p>	<ul style="list-style-type: none"> • GjEDNj, <i>Al-Saadoon and Mufdhi k.. the United Kingdom</i>, kërkesa nr. 61498/08, vendim i datës 2 mars 2010, paragrafi 115 (dënimi me vdekje — pritja e ekzekutimit) • GjEDNj, <i>Ilascu and Others k.. Moldova and Russia</i>, kërkesa nr. 48787/99, vendim i datës 8 korrik 2004, paragrafët 429-433 (dënimi me vdekje — pritja e ekzekutimit) • GjEDNj, <i>Soering k. the United Kingdom</i>, 1/1989/161/217, 7 korrik 1989, paragrafi 111 (pritja e ekzekutimit)
Legjislacioni i brendshëm	Jurisprudenca vendase

Mbrojtja plotësuese: tortura ose trajtimi apo dënimi çnjerëzor ose poshtërues

Referencat ligjore	Jurisprudenca
<p>Neni 15, germa “b”, i DK-së</p> <p>Neni 3 i KEDNj-së</p> <p>Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve të Dënimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore ose Poshtëruese, 1465 U.N.T.S. 85, 10 dhjetor 1984</p>	<ul style="list-style-type: none"> • GjDBE, <i>Mohamed M’Bodj kundër État belge</i>, çështja C-542/13, vendim i datës 18 dhjetor 2014, <i>Dhoma e Madhe</i>, paragrafët 40, 41 dhe 50 (mungesa e kujdesit të duhur shëndetësor) • GjDBE, <i>Meki Elgafaji and Noor Elgafaji kundër Staatssecretaris van Justitie</i>, çështja C-465/07, vendim i datës 17 shkurt 2009, <i>EU:C:2009:94</i>, paragrafi 28 (rëndësia e jurisprudencës së GjEDNj-së për interpretimin e fushëveprimit të Nenit 15, germa “b”, të DK-së) • GjEDNj, <i>Paposhvili k.. Belgium</i>, kërkesa nr. 41738/10, vendimi i datës 13 dhjetor 2016, paragrafët 181-193 (mungesa e kujdesit të duhur shëndetësor) • GjEDNj, <i>Trabelsi k. Belgium</i>, kërkesa nr. 140/10, 4 shtator 2014, paragrafët 113-115 (dënimi me burgim të përjetshëm) • GjEDNj, <i>M.S.S. k. Belgium and Greece</i>, kërkesa nr. 30696/09, vendim i datës 21 janar 2011, <i>Dhoma e Madhe</i>, paragrafi 220 (përkufizimi i termave “çnjerëzor” dhe “poshtërues”) • GjEDNj, <i>Gäfgen k. Germany</i>, kërkesa nr. 22978/05, vendim i datës 1 qershor 2010, <i>Dhoma e Madhe</i>, paragrafi 108 (pragu i ashpërsisë që të konsiderohet torturë) • GjEDNj, <i>Kalashnikov k. Russia</i>, kërkesa nr. 47095/99, vendim i datës 15 korrik 2002, paragrafi 95 (trajtimi poshtërues). • GjEDNj, <i>Selmouni k. France</i>, kërkesa nr. 25803/94, vendim i datës 28 korrik 1999, <i>Dhoma e Madhe</i>, paragrafët 99-101 (përkufizimi i torturës) • GjEDNj, <i>Tyrer k. the United Kingdom</i>, kërkesa nr. 5856/72, vendim i datës 15 mars 1978, paragrafi 30 (trajtimi poshtërues) • GjEDNj, <i>Ireland k. the United Kingdom</i>, kërkesa nr. 5310/71, vendim i datës 18 janar 1978, paragrafi 167 (dallimi midis torturës dhe trajtimit apo dënimit çnjerëzor ose poshtërues)
Legjislacioni i brendshëm	Jurisprudenca vendase

Mbrojtja plotësuese: kërcënimi serioz dhe individual për jetën ose personin e civilit për shkak të dhunës pa dallim në situatat e konflikteve të armatosura ndërkombëtare ose të brendshme

Referencat ligjore	Jurisprudenca
Neni 15, germa "c", i DK-së	<ul style="list-style-type: none"> • GjDBE, <i>Aboubacar Diakité k Commissaire général aux réfugiés et aux apatrides, çështja C-285/12, vendim i datës 30 janar 2014, paragrafi 35 (konflikti i armatosur)</i> • GjDBE, <i>Meki Elgafaji and Noor Elgafaji k Staatssecretaris van Justitie, çështja C-465/07, vendim i datës 17 shkurt 2009, EU:C:2009:94, paragrafët 32-33 (kërcënimi serioz dhe individual); paragrafët 34-35 (dhuna pa dallim); paragrafi 39 (prova e shkallës lëvizëse)</i> • GjEDNj, <i>K.A.B. k. Sweden, kërkesa nr. 886/11, vendim i datës 5 shtator 2013, paragrafët 75-77 (dhuna pa dallim)</i> • GjEDNj, <i>Sufi and Elmi k. the United Kingdom, kërkesa nr. 8319/07 dhe 11449/07, vendim i datës 28 nëntor 2011, paragrafi 241 (dhuna pa dallim)</i>
Legjislacioni i brendshëm	Jurisprudenca vendase

Nevojat për mbrojtje që lindin aty për aty "sur place"

Referencat ligjore	Jurisprudenca
Neni 5 i DK-së	<ul style="list-style-type: none"> • GjEDNj, <i>F.G. k. Sweden, kërkesa nr. 43611/11, vendim i datës 23 mars 2016, paragrafët 123-124 dhe 144-158 (veprimtaritë në vendin e azilit — vlerësimi i rrezikut)</i> • GjEDNj, <i>H.S. and others k. Cyprus, kërkesa nr. 41753/10 dhe 13 kërkesa të tjera, vendim i datës 21 korrik 2015, paragrafi 277 (identifikimi nga ana e autoriteteve)</i> • GjEDNj, <i>A.A. k. Switzerland, kërkesa nr. 58802/12, vendim i datës 7 janar 2014, paragrafët 38-43 (niveli i veprimtarive dhe i identifikimit nga ana e autoriteteve)</i> • GjEDNj, <i>S.F. k. Sweden, kërkesa nr. 52077/10, vendim i datës 15 maj 2012, paragrafët 68-71 (niveli i veprimtarive politike)</i>
Legjislacioni i brendshëm	Jurisprudenca vendase

Autorët e përndjekjes ose dëmit serioz

Referencat ligjore	Jurisprudenca
Neni 6 i DK-së	<ul style="list-style-type: none"> • GjDBE, <i>Mohamed M'Bodj k. État belge, çështja C-542/13, vendim i datës 18 dhjetor 2014, Dhoma e Madhe</i>, paragrafi 35 (autori i përndjekjes si kusht i nevojshëm) • GjEDNj, <i>Tatar k. Switzerland, kërkesa nr. 65692/12, Këshilli i Evropës: Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, 14 prill 2015</i>, paragrafi 41 (autorët joshtetërorë) • GjEDNj, <i>Sufi and Elmi k. the United Kingdom, kërkesat nr. 8319/07 dhe 11449/07, vendim i datës 28 nëntor 2011</i>, paragrafët 281-282 (autori i përndjekjes si kusht i nevojshëm)
Legjislacioni i brendshëm	Jurisprudenca vendase

Përgjegjësit për mbrojtjen dhe cilësia e mbrojtjes

Referencat ligjore	Jurisprudenca
Neni 1, seksioni A, paragrafi 2, i KGj-së Neni 7 i DK-së	<ul style="list-style-type: none"> • GjDBE, <i>Aydin Salahadin Abdulla and Others k. Bundesrepublik Deutschland, çështje të bashkuara C-175/08, C-176/08, C-178/08 dhe C-179/08, vendim i datës 2 mars 2010</i>, paragrafët 67-76 (mbrojtja efektive, e qëndrueshme dhe e arritshme, përgjegjësit për mbrojtjen) • GjEDNj, <i>K.A.B. k. Sweden, kërkesa nr. 886/11, vendim i datës 5 shtator 2013</i>, paragrafët 69 dhe 87 (përgjegjësit për mbrojtjen) • GjEDNj, <i>Salah Sheekh k. the Netherlands, kërkesa nr.1948/04, vendim i datës 11 janar 2007</i>, paragrafët 147-148 (mbrojtja e arritshme) • GjEDNj, <i>N. k. Finland, kërkesa nr. 38885/02, vendim i datës 26 korrik 2005</i>, paragrafët 163-164 (përgjegjësit për mbrojtjen) • GjEDNj, <i>Osman k. the United Kingdom, kërkesa nr. 23452/94, vendim i datës 28 tetor 1998</i>, paragrafët 115-116 (efektiviteti i mbrojtjes)
Legjislacioni i brendshëm	Jurisprudenca vendase

Alternativa e mbrojtjes së brendshme

Referencat ligjore	Jurisprudenca
Neni 8 i DK-së	<ul style="list-style-type: none"> • GjEDNj, A.A.M. k. Sweden, kërkesa nr. 68519/10, vendim i datës 3 prill 2014, paragrafët 66-75 (siguria në një pjesë të vendit të origjinës) • GjEDNj, K.A.B. k. Sweden, kërkesa nr. 886/11, vendim i datës 5 shtator 2013, paragrafët 80-85 (hyrja në një pjesë të vendit të origjinës, vendosja e arsyeshme) • GjEDNj, D.N.M. k. Sweden, kërkesa nr. 28379/11, vendim i datës 27 qershor 2013, paragrafët 57-59 (siguria në një pjesë të vendit të origjinës, vendosja e arsyeshme) • GjEDNj, S.A. k. Sweden, kërkesa nr. 66523/10, vendim i datës 27 qershor 2013, paragrafët 56-58 (siguria në një pjesë të vendit të origjinës) • GjEDNj, M.Y.H. and others k. Sweden, kërkesa nr. 50859/10, vendim i datës 27 qershor 2013, paragrafët 68-73 (vendosja e arsyeshme) • GjEDNj, Sufi and Elmi k. the United Kingdom, kërkesa nr. 8319/07 dhe 11449/07, vendim i datës 28 nëntor 2011, paragrafët 249 dhe 265-296 (hyrja në një pjesë të vendit të origjinës, vendosja e arsyeshme) • GjEDNj, Salah Sheekh k. the Netherlands, kërkesa nr. 1948/04, vendim i datës 11 janar 2007, paragrafët 140-148 (mbrojtja nga grupi i përkatësisë, rrethanat individuale) • GjEDNj, M.K.N. k. Sweden, kërkesa nr. 72413/10, vendim i datës 27 qershor 2013, paragrafët 35-44 (përkatësia fetare, rrethanat individuale)
Legjislacioni i brendshëm	Jurisprudenca e brendshme

Getting in touch with the EU

In person

All over the European Union there are hundreds of Europe Direct information centres. You can find the address of the centre nearest you at: https://europa.eu/european-union/contact_en

On the phone or by email

Europe Direct is a service that answers your questions about the European Union. You can contact this service:

- by freephone: 00 800 6 7 8 9 10 11 (certain operators may charge for these calls),
- at the following standard number: +32 22999696 or
- by email via: https://europa.eu/european-union/contact_en

Finding information about the EU

Online

Information about the European Union in all the official languages of the EU is available on the Europa website at: https://europa.eu/european-union/index_en

EU publications

You can download or order free and priced EU publications from EU Bookshop at: <https://publications.europa.eu/bookshop>. Multiple copies of free publications may be obtained by contacting Europe Direct or your local information centre (see https://europa.eu/european-union/contact_en).

EU law and related documents

For access to legal information from the EU, including all EU law since 1951 in all the official language versions, go to EUR-Lex at: <http://eur-lex.europa.eu>

Open data from the EU

The EU Open Data Portal (<http://data.europa.eu/euodp/en>) provides access to datasets from the EU. Data can be downloaded and reused for free, both for commercial and non-commercial purposes.



Publications Office
of the European Union